

# URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE  
BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË  
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE  
NR.133 KORRIK 2019

KRYEGJYSHATA BOTËRORE  
BEKTASHIANE



Kongresi Hebraik Amerikan, nderon Kryegjyshin Botëror Bektashian,  
Hirësinë e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, me çmimin "Profili i kurajës".

REDAKSIA:

KRYEREDAKTOR  
Syrja Xhelaj

REDAKTORË  
Nuri Çuni  
Kujtim Boriçi

KORRESPONDENTËT  
Jakup Gjoca - Greqi  
Eugen Shehu - Zvicër  
Përparim Kapllani - Kanada  
Agim Cani - Gjermani  
Enea Muhamedi - Itali

KONSULENTË  
Arian Leka  
Zenel Anxhaku  
Blerina Harizaj  
Agim Zeka  
Besnik Anxhaku

DESIGN  
Studiograf "A&N"

SHTYPET NË  
SHTYPSHKRONJËN

"Urtësia  
Bektashiane"  
Korrik, 2019



Kongresi Hebraik Amerikan, nderon Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësinë e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, me emnin "Profili i Kurajës".

### Së bashku për një jetë më të mirë

Kongresi Hebraik Amerikan, nderon Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësinë e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, me emnin "Profili i Kurajës".

Emërit e këtyre individëve janë të njohura dhe të respektuara në komunitetin bektashian dhe në komunitetin hebraik amerikan. Këto individë janë të njohur për kontributin e tyre në fushën e diplomacisë dhe të marrëdhënies ndërkulturore. Këto individë janë të njohur për kontributin e tyre në fushën e diplomacisë dhe të marrëdhënies ndërkulturore.

Emërit e këtyre individëve janë të njohura dhe të respektuara në komunitetin bektashian dhe në komunitetin hebraik amerikan. Këto individë janë të njohur për kontributin e tyre në fushën e diplomacisë dhe të marrëdhënies ndërkulturore.

Mbrëmja e 25 qershorit 2019 ka qenë veçanërisht e gëzueshme për besimtarët bektashianë, për ata që mbushën sheshin e Selisë së Shenjtë, por edhe për të tjerët, brenda dhe jashtë Shqipërisë, që ndajnë se bashku kurdoherë emocionet e ngjarjeve të mëdha. Në emër të Kongresit Hebraik Amerikan, zëvendës-presidenti Dr. Murr Kazmir, solli në këtë mbledhje vlerësimin më të lartë për Selinë tonë Bektashiane dhe Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësinë e Tij, Haxhi Dede Edmond Ibrahimaj.

### Festë në Durballi-Sulltan

Kryegjyshi Botëror Bektashian, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, pret, uron dhe bekon funksionarët shtetërorë, klerikë bektashianë e të besimeve të tjerë si dhe qindra pelegrinë të ardhur nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia Veriore, Mali i Zi, Greqia, Bullgaria, Turqia etj...

### Të pathënat me Papa Franceskun

"Fjalëve e rëndësishme në këtë rast, vjen nga kryegjyshi botëror bektashian, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili ka qenë i pranishëm në Vatikan për të diskutuar me Papa Franceskun rreth marrëdhënies ndërkulturore dhe të besimeve të ndryshme."

### Të pathënat me Papa Franceskun

Në majin e tri viteve më parë, një ditë para takimit me Atin e Shenjtë, ne si delegacion bektashian, u pritëm në Vatikan nga peshkopi Augusto Guixot Miguel.

### Udhëtim në dy epoka

Meditim në 60 vjetorin e lindjes së Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësinë e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj.

Jeta baritore dhe kodet e pasqyruara zakonisht të bektashianëve, gjatë kësaj periudhe të jetës, kanë qenë të njohura dhe të respektuara në komunitetin bektashian dhe në komunitetin hebraik amerikan.

### Udhëtim në dy epoka

Çelja e teqesë së parë bektashiane në SHBA në majin e vitit 1954 këto dit në Detroit qindra besimtarë bektashianë në përkujtim të datës së shënuar. Me një ndjenjë të ligjshme krenarie, ata iu drejtuan tyrbes ku prehen baba Rexhebi dhe baba Arshiu...

### Nga Kolonja në Backë

Në 200 vjetorin e lindjes së baba Fetahut

Kush ishte Baba Fetahu?

10 maj në Kolonjë

### Nga Kolonja në Backë

Fetah Abdurrahman Xhelaj, lindi në vitin 1819, në katundin Kolonjë të Kurveleshit nga fisi Xhelaj. Ai ndërroi jetë rreth vitit 1906. Nëna Gastare, nga fisi Mele, lindi Fetahun dhe katër vajza. Abdurahmani, merrej me bujqësi dhe blegtori.

# Së bashku për një jetë më të mirë

**Kongresi Hebraik Amerikan, nderon Kryegjyshin Botëror Bektashian, Hirësinë e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, me çmimin "Profili i kurajës".**



**M**brëmja e 25 qershorit 2019 ka qenë veçanërisht e gëzueshme për besimtarët bektashianë, për ata që mbushën sheshin e Selisë së Shenjtë, por edhe për të tjerët, brenda dhe jashtë Shqipërisë, që ndajnë se bashku kurdoherë emocionet e ngjarjeve të mëdha. Në emër të Kongresit Hebraik Amerikan, zëvendës-presidenti Dr. Munr Kazmir, solli në këtë mbrëmje vlerësimin më të lartë për Selinë tonë Bektashiane

dhe Kryegjyshin Botëror Bektashian, Hirësinë e Tij, Haxhi Dede Edmond Ibrahimaj. Qëndrimi emblemantik i shqiptarëve për të ruajtur hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore, përkujdesja e tyre pas mbarimit të asaj drame të dhimbshme, mbështetja e veçantë e bektashinjve ndaj fatit të hebrenjve si dhe ndihmesa e çmuar e Kryegjyshit Botëror në kontekstin e sotëm të afrimit të dy komuniteteve në kauzën për liri dhe drejtësi, të gjitha së bashku, sollën këtë vlerësim të lartë.

Është ekzekutuar himni jonë kombëtar dhe ai amerikan prej orkestrës frymore, duke sjellë çaste solemne, për t'ia lënë vendin më tej përsëritjes së z. Sokol Bejlëri, në cilësinë e anëtarit të nderit të Kongresit Hebraik Amerikan. Ky, pasi falënderoi Zotin për këtë mbrëmje kaq të bukur në mjediset e Qendrës Botërore Bektashiane, tha midis të tjerave: "Kam nderin të jem sot këtu para jush, Baba Mondit, miq dhe kolegë! Është një miqësi e fortë mes SHBA-ve dhe Shqipërisë, e filluar 100 vite më parë e cila vazhdon të jetë e fortë edhe sot. Shqipëria nuk ka miq më të mirë se Amerika. Është detyra jonë ta mbrojmë këtë miqësi dhe të ndërtojmë një marrëdhënie edhe më të fortë. 25 vite më parë Amerika ishte ëndërr edhe për mua. Sot kam nderin të dorëzoj këtë flamur që është valëvitur në kryeqytet e Botës në selitë e Amerikës, Baba Mondit. Është një simbol i botës së lirë dhe dhuratë për njeriun e Zotit që i ka shërbyer njerëzimit. Një burrë i madh që ushqen vlerat e lirisë dhe të drejtave fetare. Ai jeton për të bërë të mira, të bashkojë njerëzit e besimeve të ndryshme. Është nder t'i jap flamurin e SHBA si shenjë e vlerësimit të pakufishëm për Komunitetin Bektashian në Shqipëri. Zoti ju bekoftë!"

Pastaj ai ftoi z. Munr Kazmir të dorëzonte flamurin e Kongresit Hebraik Amerikan, në mirënjohje të kontributit të çmuar të Kryegjyshit Botëror Bektashian, si në promovimin e vlerave të vjera të harmonisë fetare në botë, ashtu edhe për afrimin dhe sendërtimin e një vëllazërie të përjetshme midis shqiptarëve dhe kombit hebre. Duke e falënderuar sinqerisht për këtë nder, Kryegjyshi Botëror Bektashian tha: "...Është kënaqësi e veçantë për mua, të përsëritës këtë ceremonial modest për vlerësime të shkëlqyera që i bëhen Selisë së Shenjtë Bektashiane, ndaj më lejoni që së bashku me lutjet, t'ju përcjell urimet më të begata për ju dhe familjet tuaja. Zoti i Lartë qoftë pranë jush në çdo rrahje të shpirtit! Selinë e Shenjtë Bektashiane, në këto tri dekada të ringritjes

së saj, e kanë vizituar personalitete të lartë fetare, duke dëshmuar respektin e thellë dhe ndjenjat më të kulluara për tarikat tonë, i cili në udhëtimin e tij tetëshekullorë ka shpalosur fytyrën e vërtetë të devotshmërisë ndaj Krijuesit, frymën e dashurisë njerëzore dhe vëllazërinë e çiltër fetare. Komuniteti ynë prej dhjetëra milionësh, besimtarë të urtë të shpërndarë në Europë, Azi, SHBA dhe deri në Australinë e largët, u janë mirënjohës këtyre personalitetëve për vlerësimet dhe mbështetjen e tyre. Në këtë varg të gjatë personalitetesh, padyshim zë vendin e tij të merituar Dr. Mynir Kazmir, zëvendës president i Kongresit Hebraik Amerikan, i cili prej katër dekadash ka dhënë kontributin e çmuar të tij njerëzor në disa kontinente, duke mundur të sensibilizojë dhe të ngrrejë në këmbë komunitete të tërë intelektualësh dhe veprimtarish në ndihmë të njerëzve në nevojë, në bashkëpunim me parimet e Zotit, për të mbyllur sa më shumë plagë fizike dhe shpirtërore të shoqërisë së sotme plot brenga. Miku ynë, Dr. Kazmir, është vlerësuar lart në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për angazhimin kurajoz të tij, kundër përdoruesve të rinj të alkoolit, drogës, duhanit, armëve të zjarrit apo eksplozivëve, duke inkurajuar përmes programeve frutdhënës programe drejtimi dhe trajnimit që motivojnë zbatimin e ligjit dhe sjellin paqen aq shumë të dëshiruar. Inkurajimet e tij, ndaj uniteteve fetare dhe kulturorë, në kohëra dhe vende të ndryshme, kanë dhënë shpresë për shuarje konfliktesh, dhe ndërtimit të urave të bashkëzistencës multi-fetare dhe multi-etnike. Ne ndjehemi krenarë që kemi sot mes nesh një mik të shquar dhe po aq të gëzuar për dhuratën e Kongresit Hebraik Amerikan, flamurin e shenjtë, të përcjellë përmes Dr. Kazmir. Ne meritojmë plotësisht këtë nder, sepse Selia e Shenjtë Bektashiane, prej vitit 1992 dhe deri më sot, ka kryer misionin e shenjtë fetar, mbajtjen pastër të traditës dhe pasurimin e Islamit, në përpunje të plotë me kontekstet kohorë. Ne kemi trashëguar një lidhje shumë vëllazërore me Shtetet



e Bashkuara të Amerikës dhe Ambasadën e saj në Tiranë, të cilën po e forcojmë dita-ditës, në luftë të papajtueshme për çdo qëndrim apo praktikë ekstremiste që kërkon të dëmtojë besimin tonë. Shembulli i shkëlqyer i harmonisë fetare shekullore në Shqipëri, ajo që Papa Françesku e quajti përpara pak kohe "Vëllazëri fetare", ka brenda tij përveç të tjerave edhe kontributin e bektashinjve, të cilët iu gjendën pranë atdheut të tyre në kohërat më të vështira, në ngjarjet më të skajshme të historisë, duke dëshmuar dashurinë unike për Zotin dhe vatanin. Ne ende sot, japim kontributin tonë, në këto ditë të vështira politike, duke u lutur dhe duke bërë thirrje për urtësi e paqe."

Më pas të pranishmit ndoqën fjalën e Dr. Munr, i cili midis të tjerave tha: "Është vërtet një nder të jem këtu sot. Do të doja të falënderoja veçanërisht zëvendësambasadoren Leyla Moses Ones për mikpritjen e saj të ngrohtë gjatë vizitës sime. Qëndroj këtu para jush sot në tokë të shenjtë.

Qëndroj para jush sot në këtë tokë, në këtë komb, që kishte kurajën të bënte atë që pak të tjerë guxuan të bënin për popullin tonë. Qëndroj këtu para jush sot, së pari dhe mbi të gjitha për të ofruar atë që ne në judaizëm e quajmë Hakarat Hatov, një njohje, apo më mirë një vlerësim të thellë për një favor të bërë. Qëndroj përpara jush sot i përlulur përpara atyre që i bënë ballë makinerisë së tmerrshme vrasëse të luftës naziste dhe thanë: ne nuk do t'i dorëzojmë hebrenjtë tanë në masakër, ne nuk do ta kthejmë kokën nga ana tjetër, ne nuk do të jemi spektatorë, ne do të jemi pjesëmarrës aktivë për të bërë atë që është e drejtë, pavarësisht kostos. Është e pamundur që unë të qëndroj përpara jush sot pa ju thënë më parë: Faleminderit! Si zëvendës-president i Kongresit Amerikan Hebre, unë jam me fat që përfaqësoj një agjenci që ka luftuar dhe është përpjekur për rikrijimin e shtetit hebre që nga viti 1918. Misioni ynë 100-vjeçar ka qenë dhe



**Izraeli dhe Shqipëria kanë shumë cilësi të përbashkëta, për të cilat mund të jenë krenare. Të dyja vendet e kuptojnë atë që duhet për të ruajtur vlerat, kulturën tonë, të drejtat e njeriut, edhe në hijen e fuqive të huaja armiqësore. Shtetet e Bashkuara janë toka e nënshtetësisë sime. Ka mbi dyqind mijë shqiptarë në Shtetet e Bashkuara dhe ata janë gjithashtu qytetarë të vlerësuar dhe anëtarë të komuniteteve të tyre. Di që ka një shprehje të mrekullueshme këtu në Shqipëri, është diçka e tillë: "Besa e një shqiptari nuk mund të shitet apo blihet në pazar". Ky proverb është emblematic për popullin shqiptar. Siç ju e dini shumë mirë, gjatë ditëve të errëta të pushtimit nazist, njerëzit tanë u gjurmuan dhe u izoluan nëpër Europë, si kafshët. Nën hundën e pushtuesve, populli shqiptar iu dha hebrenjve që po largoheshin nga Europa Qendrore dhe Jugore, strehim dhe ndihmë. Ata iu dhanë atyre veshje dhe strehë dhe i thërrisnin me emra shqiptarë për të mashtruar pushtuesit nazistë. Në Shqipëri, të afërmit tuaj nuk i dorëzuan hebrenjtë në duart e vdekjes. Ju nuk ia kthyet kurrizin popullit tonë dhe kjo është diçka që ne nuk mund të lejojmë kurrë që të harrohet.**

vazhdon të jetë promovimi i vlerave të përbashkëta i të gjitha besimeve, në Amerikë, në Europë dhe rreth botës. Nën drejtimin e Presidentit Jack Rosen, Kongresi Amerikan Hebre ka arritur nivele të reja të larta dhe ne po punojmë sot më të fortë dhe më të bindur se kurrë për të promovuar bashkëpunim ndërkombëtar dhe dialog mes besimeve dhe popujve. Këto përpjekje dhe marrëdhënie më kanë sjellë marrëdhënien e sinqertë që kam me Sokol Bejlerin dhe do të isha i pakujdesshëm nëse nuk e marr mundësinë për ta falënderuar atë, që më ka njohur me këtë tokë të mrekullueshme. Si njeri modest, Sokoli nuk ka dëshiruar kurrë të mbulohej me elozhe. Megjithatë,

unë jam i sigurt se me gjithë zhgënjimin e tij, ndihem i detyruar t'i jap vlerësimin që meriton. Sokoli erdhi në Shtetet e Bashkuara shumë vite më parë me pak para. Dhe asnjë njohje. Një nga vajzat e tij u përfshi në një aksident të tmerrshëm dhe i nevojitej një ndërhyrje e specializuar. Ndërhyrja do të konsumonte të gjitha kursimet e fituara me vështirësi nga Sokoli. Sokolit iu ofrua një linjë financiare shpëtimi nga spitali. Ndërhyrja do të paguhej nga bamirësia e spitalit. Miku im Sokoli nuk i pranoi paratë, për shkak të krenarisë dhe vetëmjaftueshmërisë. Ai bëri atë që mendoi se ishte e drejtë. Ai siguroi për familjen e tij në mënyrën më të mirë që dinte, qëndroi në principet e veta, edhe




atëherë kur ishte momenti më i vështirë. Sot ai është një njeri i shquar dhe i respektuar në Nju Jork Siti dhe në industrinë e tij. Është lider në komunitetin e tij, i cili e do vendin e tij. Ne kemi bashkëpunuar në një sërë projektesh humanitare, përfshirë një shkollë të nivelit të lartë në tokën time të lindjes, në Pakistan. Sokol Bejleri është një vlerë për kombin tuaj dhe shqiptarët kudo.

Izraeli dhe Shqipëria kanë shumë cilësi të përbashkëta, për të cilat mund të jenë krenare. Të dyja vendet e kuptojnë atë që duhet për të ruajtur vlerat, kulturën tonë, të drejtat e njeriut, edhe në hijen e fuqive të huaja armiqësore. Shtetet e Bashkuara janë toka e nënshtetësisë sime. Ka mbi dyqind mijë shqiptarë në Shtetet e Bashkuara dhe ata janë gjithashtu qytetarë të vlerësuar dhe anëtarë të komuniteteve të tyre. Di që ka një shprehje të mrekullueshme këtu në Shqipëri, është diçka e tillë: "Besa e një shqiptari nuk mund të shitet apo blihet në pazar". Ky proverb është emblematic për popullin shqiptar. Siç ju e dini

shumë mirë, gjatë ditëve të errëta të pushtimit nazist, njerëzit tanë u gjurmuan dhe u izoluan nëpër Europë, si kafshët. Nën hundën e pushtuesve, populli shqiptar iu dha hebrenjve që po largoheshin nga Europa Qendrore dhe Jugore, strehim dhe ndihmë. Ata iu dhanë atyre veshje dhe strehë dhe i thërrisnin me emra shqiptarë për të mashtruar pushtuesit nazistë. Në Shqipëri, të afërmit tuaj nuk i dorëzuan hebrenjtë në duart e vdekjes. Ju nuk ia kthyet kurrizin popullit tonë dhe kjo është diçka që ne nuk mund të lejojmë kurrë që të harrohet. Ky principi shqiptar, "Besa" ka shpëtuar shumë mijëra jetë. Shqiptarët i dhanë "Fjalën e Nderit" hebrenjve për të cilët u kujdesën. Ka një shprehje këtu në Shqipëri, që kur pi ujë, kujtoje burimin. Hebrenjtë nuk do ta harrojnë kurrë "khasideiumótha'olám" apo burrat dhe gratë e së drejtës që kanë ndihmuar njerëzit tanë në ato kohëra të errësirës. Që nga hija e Luftës II Botërore dhe rënia e komunizmit, liria e besimit ka lulëzuar në pjesën më të madhe të botës, përfshi edhe Shqipërinë. Sot

**Ne ndjehemi krenarë që kemi sot mes nesh një mik të shquar dhe po aq të gëzuar për dhuratën e Kongresit Hebraik Amerikan, flamurin e shenjtë, të përcjellë përmes Dr. Kazmir. Ne meritojmë plotësisht këtë nder, sepse Selia e Shenjtë Bektashiane, prej vitit 1992 dhe deri më sot, ka kryer misionin e shenjtë fetar, mbajtjen pastër të traditës dhe pasurimin e Islamit, në përputhje të plotë me kontekstet kohorë. Ne kemi trashëguar një lidhje shumë vëllazërore me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Ambasadën e saj në Tiranë, të cilën po e forcojmë ditaditës, në luftë të papajtueshme për çdo qëndrim apo praktikë ekstremiste që kërkon të dëmtojë besimin tonë. Shembulli i shkëlqyer i harmonisë fetare shekullore në Shqipëri, ajo që Papa Françesku e quajti përpara pak kohe "Vëllazëri fetare", ka brenda tij përveç të tjerave edhe kontributin e bektashinjve, të cilët iu gjendën pranë atdheut të tyre në kohërat më të vështira, në ngjarjet më të skajshme të historisë, duke dëshmuar dashurinë unike për Zotin dhe vatanin. Ne ende sot, japim kontributin tonë, në këto ditë të vështira politike, duke u lutur dhe duke bërë thirrje për urtësi e paqe."**

Shqipëria gëzon një marrëdhënie shumë të mirë me shtetin e Izraelit dhe popullin hebre. Unë shpresoj që ne të vazhdojmë të forcojmë dhe thellojmë këto ndërveprime, në të mirë të popujve tanë. Në të njëjtën kohë, shqiptarët janë mes njerëzve më pro amerikanë në Europë. Në këto kohëra sfidash që po jetojmë, është e rëndësishme të dimë se njerëzit që e duan lirinë në Shtetet e Bashkuara dhe në Shqipëri ndajnë vlera të përbashkëta dhe janë të përkushtuar



për vazhdimin e miqësisë sonë. Ne e dimë se liritë themelore, sidomos liria e besimit, si dhe shtypi i lirë dhe një sistem i pavarur gjyqësor, duhet të mbrohen nga zgjedhje të lira dhe të hapura. Principi shqiptar i "besës" do t'i forcojë njerëzit dhe fuqizojë ata për të ndërtuar një të ardhme më të fortë. Shqipëria është një demokraci e re dhe e gjallë që premtion shumë. Lëvizja përpara na lejon të gëzojmë vlerat që ne ndajmë. Të gjithë ne që jemi të pranishëm këtu, duhet ta dimë që ju mund të mbështeteni gjithmonë në Shtetet e Bashkuara. Shqipëria është një mik i vërtetë për Shtetet e Bashkuara dhe Shtetet e Bashkuara janë një mik i vërtetë për Shqipërinë. Ne duhet të vazhdojmë ta forcojmë këtë aleancë dhe unë kam besim te të gjithë ne, që do të punojmë për të ruajtur miqësinë tonë. Shtetet e Bashkuara, shteti i Izraelit dhe Shqipëria mund të presin përpara shumë vite miqësie të hapur dhe të ngushtë. Është shpresa ime që kombet tona mund të bashkohen nga vlerat tona të përbashkëta.

Siç e theksova më parë, Kongresi Amerikan Hebre punon palodhur për të promovuar dialogun ndërfe-tar. Islami, judaizmi dhe krishterimi ndajnë vlera të përbashkëta. Vlerat e Atit tonë të përbashkët biblik, Abraham, vazhdojnë sot në Shqipëri dhe ato janë ilustruar nga baba Mondhi dhe komuniteti bektashian. Bektashinjtë, një komunitet i bazuar në principet e tolerancës, dashurisë dhe respektit reciprok, shpesh e gjejnë veten në një botë armiqësore që nuk i ndan këto vlera. Ka mijëra bektashinj që përballen me diskriminimin, thjesht sepse iu qëndrojnë besnikë



**Në këto kohëra sfidash që po jetojmë, është e rëndësishme të dimë se njerëzit që e duan lirinë në Shtetet e Bashkuara dhe në Shqipëri ndajnë vlera të përbashkëta dhe janë të përkushtuar për vazhdimin e miqësisë sonë. Ne e dimë se liritë themelore, sidomos liria e besimit, si dhe shtypi i lirë dhe një sistem i pavarur gjyqësor, duhet të mbrohen nga zgjedhje të lira dhe të hapura. Principi shqiptar i "besës" do t'i forcojë njerëzit dhe fuqizojë ata për të ndërtuar një të ardhme më të fortë. Shqipëria është një demokraci e re dhe e gjallë që premtion shumë. Lëvizja përpara na lejon të gëzojmë vlerat që ne ndajmë. Të gjithë ne që jemi të pranishëm këtu, duhet ta dimë që ju mund të mbështeteni gjithmonë në Shtetet e Bashkuara. Shqipëria është një mik i vërtetë për Shtetet e Bashkuara dhe Shtetet e Bashkuara janë një mik i vërtetë për Shqipërinë. Ne duhet të vazhdojmë ta forcojmë këtë aleancë dhe unë kam besim te të gjithë ne, që do të punojmë për të ruajtur miqësinë tonë. Shtetet e Bashkuara, shteti i Izraelit dhe Shqipëria mund të presin përpara shumë vite miqësie të hapur dhe të ngushtë. Është shpresa ime që kombet tona mund të bashkohen nga vlerat tona të përbashkëta.**

këndvështrimeve të tyre themelore, mbi të cilat bazohen besimet tona të forta. Fatmirësisht, ka individë që me guxim qëndrojnë në mbrojtje të dinjitetit njerëzor. Kjo është një dhunti e Baba Mondit. Së fundmi kam pasur privilegjin ta takoja atë dhe njoha një njeri të madh besimi, i cili është thellësisht i përkushtuar për të promovuar tolerancën dhe harmoninë fetare. Ai është i nderuar dhe i respektuar nga njerëzit e të gjitha besimeve në Shqipëri, Ballkan dhe rreth botës.

Baba Mondit ka punuar shumë për t'u angazhuar me njerëz të të gjitha besimeve dhe të bëhet shembull i bashkëjetesës së famshme fetare dhe tolerancës së besimit të shqiptarët. Ai ka punuar për të ndërtuar ura komunikimi me njerëzit e të gjitha besimeve, përfshirë hebrenjtë. Ai ka kultivuar marrëdhënie të vlefshme personale me liderët hebrej dhe ai është angazhuar në promovimin e iniciativave të përbashkëta mes komuniteteve bektashinje dhe hebrej. Përveç kësaj, ai ka shprehur mbështetjen e vendosur për shtetin hebre. Disa vite më parë, baba Mondit hodhi poshtë dhe korrigjoi një sulm verbal të pajustificuar të një lideri të Lindjes së Mesme mbi Izraelin. Është e lehtë të dënosh veprimet e armiqve apo konkurrentëve. Është e lehtë të bësh shembuj të atyre, me të cilët ne nuk ndajmë vlera të përbashkëta, por duhet kuraja më e madhe për të qëndruar në krah të atyre me të cilët ndajmë vlera në kohëra të fatkeqësive të tyre. Duhet kurajë për të sfiduar status quo-në. Baba Mondit ka thënë: "Nuk ka vend për dhunë në besim. Besimi duhet të jetë pastërtisht shpirtëror".

Çdo ditë, imazhe të intolerancës fetare dhe paragjykitimit dalin në lajme dhe media. Sulme në dinjitetin e besimtarëve të lirë krijojnë frikë dhe përçajnë komunitete, për të cilat janë dashur dekada që të ndërtohen. Pikërisht, nuk ka vend për dhunë në besim. Nëse historia duhet të na mësojë diçka, ne do të mësojmë që burrat dhe gratë e vullnetit të mirë, me vetëm një kauzë morale, kanë fuqinë për të ndryshuar botën për më mirë. Besimi abrahamik, besimi ynë, i mëson ndjekësit që të bëjnë mirë. Ai i mëson njerëzit që të marrin përgjegjësi aktive, të kujdesen për njëri-tjetrin dhe të kërkojnë rregull dhe harmoni. Natyra përçarëse e mosmarrëveshjeve globale mund të përmbysset nga mirëkuptimi mes besimeve dhe



**Natyra përçarëse e mosmarrëveshjeve globale mund të përmbysset nga mirëkuptimi mes besimeve dhe një besueshmëri universale në vlerën dhe dinjitetin e njeriut. Përpjekjet e baba Mondit kanë pasur një ndikim të pathënë në afrimin e dy komuniteteve tona në kauzën për drejtësi dhe liri. Është një nder i madh për mua, një hebre i lindur në Pakistan, të paraqes një çmim të tillë. Së bashku ne vazhdojmë të zgjerojmë lirinë fetare, të promovojmë një shoqëri të lirë dhe të hapur dhe të ndërtojmë një të ardhme më të mirë për fëmijët tanë. Baba Mondit, përpjekjet tuaja për të promovuar paqen, për të forcuar vëllazërinë dhe për të çuar përpara partneritetin dhe dialogun ndërfaqetarak do ta bëjnë këtë botë një vend më të mirë. Në emër të Kongresit Amerikan Hebre, është kënaqësia ime më e madhe t'i jap çmimin "Profili i Kurajës" Baba Mondit, liderit të Qendrës Botërore Bektashiane."**

një besueshmëri universale në vlerën dhe dinjitetin e njeriut. Përpjekjet e baba Mondit kanë pasur një ndikim të pathënë në afrimin e dy komuniteteve tona në kauzën për drejtësi dhe liri. Është një nder i madh për mua, një hebre i lindur në Pakistan, të paraqes një

çmim të tillë. Së bashku ne vazhdojmë të zgjerojmë lirinë fetare, të promovojmë një shoqëri të lirë dhe të hapur dhe të ndërtojmë një të ardhme më të mirë për fëmijët tanë. Baba Mondit, përpjekjet tuaja për të promovuar paqen, për të forcuar vëllazërinë dhe për të çuar përpara partneritetin dhe dialogun ndërfaqetarak



do ta bëjnë këtë botë një vend më të mirë. Në emër të Kongresit Amerikan Hebre, është kënaqësia ime më e madhe t'i jap çmimin "Profili i Kurajës" Baba Mondit, liderit të Qendrës Botërore Bektashiane." Fjala e Dr. Munr është pritur me kënaqësi të veçantë jo vetëm për klerikët dhe besimtarët bektashinj, por edhe përfaqësuesit e lartë fetarë pjesëmarrës, amba-

sadorët e trupit diplomatik të akredituar në Tiranë si dhe personalitete të tjerë të shquar në botën intelektuale dhe akademike të Shqipërisë. Një koncert mbresëlënës nga Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve Popullore, e bëri ende më të bukur këtë mbrëmje. Për të ftuarit dhe miqtë nga larg, u shtrua darkë.



# Festë në Durballi-Sulltan



**Kujtim BORIÇI, Nuri ÇUNI**

**E**rrethuan me tela me gjemba dhe me roje për dekada të tëra teqenë e njohur të "Durballi Sulltanit" në Volos të Greqisë, ushtruan presion e dhunë ndaj besimtarëve të cilëve u mohonin vizitat e pelegrinazhet në këtë vend të shenjtë, por nuk mundën që të ndërpresin lidhjet shpirtërore dhe udhën e shpresës së besimtarëve me rrugën e Haxhi Bektash Veliut, derisa u arrit që kjo strehë e mohuar, të ribëhet strehë e besimtarëve. Tashmë, edhe pse ligjërisht shteti fqinj ja ndalon aktivitetin kësaj teqeje të njohur bektashiane, karvanët e pafund të besimtarëve vazhdojnë të shkojnë atje, të gjejnë strehë, prehje, shpresë e besim për të ardhmen, paqen, mirësinë, dashurinë e adhurimin për Zotin e Plotfuqishëm. Dhe besimtarët janë të racave

*Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, pret, uron dhe bekon funksionarë shtetërorë, klerikë bektashianë e të besimeve të tjerë si dhe qindra pelegrinë të ardhur nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia Veriore, Mali i Zi, Greqia, Bullgaria, Turqia etj...*

e besimeve të ndryshme, kanë etnitete të ndryshëm e flasin gjuhë të ndryshme, por aty mblidhen çdo ditë në strehën e paqte bektashiane në vëllazërinë e këtij besimi të shenjtë. Veçanërisht, ky fluks, është tejet i madh në ditën tradicionale të pelegrinazhit të përvitshëm, çdo 1 maj. Kështu ndodhi edhe këtë vit... "Pelegrinazhi i këtij viti në 'Durballi Sulltan', qoftë nga pjesëmarrja e



madhe, qoftë dhe nga mënyra e organizimit, është një nga frytet e punës tonë të pandërprerë si Kryegjyshitë, në përballje me struktura shtetërore e qarqe ekstremiste, në mënyrë që të evitohen sa më shumë pengesat për rikthimin e objekteve bektashiane kudo që janë në botë në funksion të besimtarëve. Pikërisht, është mbështetja e miliona besimtarëve kudo në botë, që ne marrim forcë për realizimin e këtij objekti. Rasti i teqesë së Volosit në Greqi, është produkt i kësaj pune. Me këtë rast, unë dua të falënderoj kryesisht besimtarët emigrantë nga Shqipëria, që prej vitesh janë përballur me segmente shtetërore që të fitonin shkuarjen e lirë tek ky vend i shenjtë, të meremetonin me mundësitë e tyre rrethimin, deri dhe hapjen e rregullimin e rrugës tejet të amortizuar”-pohon mes të tjerave Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj.

## Teqeja e “Durballi Sulltanit”

Teqeja e “Durballi Sulltanit” në Volos të Greqisë, është një nga objektet bektashiane me një histori të veçantë udhën 800 vjeçare të bektashizmit. Ja shkurtimisht pak nga historia e kësaj teqeje: Teqeja e Durballi Sulltanit në fshatin Asprogeias (Ireni). Larg qytezës së Farsalës 28

km, nga Larisa (prefekturë) 72 km, dhe nga Volosi, 38 km. Është ndërtuar në majën e një kodre të rrumbullakët, ku ka një bukuri të veçantë, nga më të bukurat e krahinës, një mrekulli, me ndërtesat dhe natyrën e pashoq. Rrethohet nga vargmalet Halkodionius me fshatin Rigeo (Ajvali) dhe. Nga tjetër ku janë skajet e malit Kasidhiaris të Fasalës, gjendet stacioni Rigeos, e 2 km më tej ndodhet fshati Asprogeia (Ireni), ose sot i thonë, teqeja në Rini.. Ndërtesa kryesore me hyrje lindore, ndërtuar në buzë të grykës, është një kompleks arkitektonik i larmishëm me godina të veçanta dhe në hyrje të kompleksit, gjendet i ndërtuar një krua i vjetër dhe para saj me rrape të vjetër shekullor. Hapësira qendrore e teqesë ndan me muret e varrezës, faltorja, vende për banim, për mikpritje, falje, furra dhe kuzhina. Teqeja në kohën e lulëzimit ka pasur pronësi në dy fshtatra të tërë, çifligun e Arduanit (Elefterohori i Volosit) dhe Ireninë (Asprogeia e Farsalës), një sipërfaqe totale prej 32.000 dynmësh. Mbante 300-400 kokë bagëtish të imta. Kjo teqe është mbyllur për herë të fundit më 30.11.1972, ku dha frymën e fundit baba Seit Koka nga Vëndresha e Skraparit. Baba Seitin, besimtarët e zonës e kanë njohur si njeri popullor, që u fliste të gjithëve me mirësi; ishte një bamirës i vërtetë i krahinës. Studiuesi nga rajoni i Volos, Georgios Thomas, shkruan për baba

Seitin: ‘...I fundmi shqiptar zemërmirë i teqesë ta prijë në një vizitë në dhjetëvjeçarin 1960, ta përcjell dhe ta shëtisë këndeje e andej me harkan e gjelbrët dhe me taxhin, me zymbylin e Indisë në duar, thua se ishte nderje e ca figurave biblike të endet në ndërtesat e vjetra’. Baba Seitin i shprehet Georgos: ‘Që thua, njeriu im i mirë, njerëzia dhe vegjelia rrinin në këtë gërmadhë, veçan dervishëve, dyqind persona të tillë aso kohe. Të lëmë një të krishterë udhëtar përjashta? Kurrë, kurrë. Çdo të thotë shqiptar apo grek, i krishterë apo mysliman? Amin, a nuk jemi të gjithë njerëz të Perëndisë? Një Zot ekziston, Atij i faleni ju, Atij edhe ne. A nuk e tha Krishti ‘Duajeni njeri-tjetrin’. Baba Qazimin e nderonte gjithë zona (vitet 1920-1942), sepse banorët kishin ndërje dorën e tij ndihmëtare për familjet e tyre. Por fundi tragjik, qe, kur në pranverën e vitit 1942, kur kaloi batalioni italian; e kapën dhe ekzekutuan se kishin informata që merrte pjesë në rezistencën e popullit. Të flasësh për baba Seit Kokën, do njohur pak historia e teqesë së famshme Durballi Sulltanit, e themeluar në vitin 1480 në Farsalla të Greqisë. Durballi Sulltani, ky misionar ishte dërguar nga Sejid Ali Sulltani, i teqesë së Dimotekës në Bullgari. Durballi Sulltani themeloi teqenë dhe e bëri të njohur jo vetëm në Ballkan, por edhe në botë. Ai e drejtoi teqenë për 42 vjet, deri në vitin 1552. Ai njihet si baba i famshëm për një veprimtari të madhe dhe ka qenë shenjtor i madh. Besimtarët e zonës dhe gjithë popullata në këtë trevë edhe sot flasin për këtë shenjtor të mrekullueshëm. Teqeja përbëhet nga dy njësi hapësinore: varrezat dhe tempulli kryesor. Në hapësirën e varrezave gjenden varret e dervishëve

dhe në anën perëndimore dy tyrbe ku janë varrosur prindërit (baballarët). Hapësira kryesore e teqesë përbëhet nga ndërtime të ndryshme: hapësira banimi, mikpritjeje, adhurimi, si dhe furra, kuzhina sipas konceptit arkitekturor të Qendrës Botërore të Bektashizmit në Nevshahir të Turqisë, sot Haxhi Bektash. Interes të posaçëm nga pikëpamja arkitekturore, paraqet ngrehina e rrënuar nga ana lindore dhe ndërtime të tjera që i japin këtij kompleksi të rrallë, një bukuri të veçantë. Durballi Sulltani ishte edhe një mistik i madh për këtë tregon një vjershë e bërë për të nga baba Abedin Leskoviku: Aman! Ja Durballi-Un’ jam kull te ty, / Qerem ja Mahzuni- ja nurler nuri / Sulltan Sejd Ali-Sërri Bektashi, / Je soj Pejkamberi-Je Rum Serveri / Qeramete shumë-i derdhe si kumnë...!

## Dita e pelegrinazhit

Dita e pelegrinazhit të këtij viti, ka qenë ndër pelegrinazhet me pjesëmarrje më masive të zhvilluara këto vitet e fundit në teqenë “Durballi Sulltan” në Volos të Greqisë, por dhe më e organizuar dhe e paqta. Prej ditësh, nën përkujdesjen e Kryegjyshit, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, ishin marrë masa për një organizim sa më të mirë, ashtu dhe për një pjesëmarrje sa më të madhe të besimtarëve nga Shqipëria. Një pjesë e besimtarëve nga Shqipëria ishin nisur që dy dit më parë dhe i kaluan netët në mjediset e teqesë së “Durballi Sulltanit”, e cila ishte kthyer në një qytezë të madhe e të ndriçuar, me një mori çadrash e objekte të tjera akomodimi, ku dëgjoheshin nefese e këngë bektashiane në shqip, greqisht, anglisht, turqisht, arabisht dhe në gjuhë të tjera. Ndërsa







një pjesë tjetër e organizuar me furgonë e automjete udhëtoi nga Tirana e rrethe të tjera të Shqipërisë drejt Volosit, që më 30 prill, për të qenë atje që në orët e para të pelegrinazhit të nesërm të 1 majit. Merushja, ndonëse me moshë të thyer, njëkohësisht shërben dhe si cicerone, pasi ka qenë dhe herë të tjera në këtë vend të shenjtë. Ndër besimtarët nga Shqipëria, ka dhe shumë të rinj që kanë ardhur këtë ditë në teqenë e njohur të "Durballi Sulltanit". Kurse Arben Sulejmani, paraprinë karvanin e automjeteve të shumtë që kanë udhëtuar nga Tetova, Shkupi, Kërçova e Gostivari, për në Volos të Greqisë...

Mëngjesi i ditës festive bektashiane, i ngjanë një feste të vërtetë bektashiane. Vallet tashmë, kërcehen së bashku nga besimtarë të etniteteve të ndryshme, ndërsa zëri i këngëtarit të njohur Ylli Baka, udhëtuar për në Volos enkas për këtë event, ja shton bukurinë pelegrinazhit. "Kam kënduar shumë në jetën time, edhe në aktivitete të bektashinjve, por ky aktivitet i sotëm, ka diçka të veçantë, ka larmi etnitetesh të besimtarësh, biseda në shumë gjuhë, por që i bashkon vëllazëria bektashiane. Ku ka gjë më të bukur. Faleminderit Dede Edmond Brahimaj që na jep kënaqësi të tilla, zhvillon aktivitete të tilla që forcojnë vëllazërinë e dashurinë tek Zoti"- shton një moment këngëtarin Baka.

Në këtë aktivitet ka ardhur dhe Konsullja e Shqipërisë në Selanik, Pavlina Evro. Kanë ardhur gjithashtu, përveç klerikëve nga Shqipëria, edhe klerikë bektashianë nga Kosova, Republika Veriore e Maqedonisë, nga Turqia etj... Në një moment, grupet festive grumbullohen në sheshin e teqesë, ku nis dhe ceremonia zyrtare.

## Përrshëndetja e Kryegjyshit

Pasi e ka pasur thujtë të pamundur të shkëputet nga grupet e besimtarëve të shumtë që kërkojnë ti puthin duart, të marrin bekimin apo të bëjnë një foto së bashku, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj, bashkë me klerikët e tjerë dhe funksionarët shtetëror ngjitet në tribunën dhe bën përrshëndetjen e rastit. Ndër të tjera theksoi: "...Është sigurisht vullneti i të Madhit Zot por edhe devotshmëria dhe mirësia juaj që na ka mbledhur sot të gjithëve, në këtë vend të bekuar në teqenë e famshme bektashiane që mban emrin e themelonjësit të saj, Durballi Sulltanit. Është filozofia e Haxhi Bektash Veliut, esenca e së cilës flet vetëm paqe dhe vëllazëri fetare, e cila na ka mbledhur së bashku në këtë ditë pelegrinazhi. E themeluar më shumë se pesë shekuj më parë, ky kult i tarikatit bektashian, teqeja e mrekullueshme do të shpërndante dritën e besimit në Zot për breza të tërë besimtarësh. Popujt në përgjithësi, por sidomos popujt e viseve të Ballkanit, në vetëdijen e tyre fetare e patën kuptuar rëndësinë e konvergimit të feve dhe besimeve në një Zot të vetëm, ndaj dhe iu falën Atij, sipas kodeve zakonore dhe mënyrave të tyre, gjithmonë me shpresën për një jetë më të qetë larg mërive racore dhe etnie, larg gjuhës së dhunës dhe urrejtjes. Pikërisht këtë mision të shkëlqyer të objektit të kultit, e ka realizuar më së miri teqeja këtu në Irini të Frasalës, në këtë vend kaq të begatë dhe mikpritës. Dervishët dhe baballarët që kanë shërbyer në këtë prehtore të shpirtit dhe të trupit, duke përcjellë në shekuj urtësinë karakteristike bektashiane, kanë bërë të mundur ta shndërronin këtë vend në një

manastir të vërtetë, ku njerëz të ndryshëm, besimtarë ose jo të tillë, syni dhe bektashinj, të krishterë apo hebrenj, vinin plot dhimbje dhe shkonin plot shpresë. Dyert e teqesë për pesëqind vjet nuk u mbyllën asnjëherë, për askënd dhe kjo e shndërroi objektin në fjalë, në simbolin e shtëpisë së Zotit. Fakte të tilla, të mikpritjes dhe bujarisë së dervishëve dhe baballarëve të teqesë, janë të shumta dhe janë vënë në pah si nga historiografia otomane ashtu edhe ajo greke. Janë me dhjetëra autorët që rrëfejnë jo vetëm mikpritjen por edhe ndjenjat e kulluara të vëllazërisë që kjo teqe shpërndante. Në këtë kuptim, një vizatim me të vërtetë brilant është dhënë nga autori Andrea Karkavitas në gazetën "Estia" Athinë 1892. Ne jemi me fat sot, kur kujtojmë se në këtë teqe kanë dhënë kontributin e tyre të çmuar edhe disa dervish dhe baballarë nga Shqipëria, deri më i fundmi, baba Seiti nga Vëndresha e Skraparit, i cili mbylli sytë në vitin 1972. Përreth teqesë ka ende sot plot qytetarë të mirë grekë që sjellin ndërmend këtë klerikë të urtë që shpërndau mirësi gjithë jetën e vet. Veçanërisht sot, ne kemi nevojë më shumë se kurrë për dashurinë ndaj Zotit. Kemi nevojë të jemi të vëllazëruar dhe të jetojmë në paqe me çdo fe dhe besim. Zoti ju bekoftë të gjithëve ju që erdhët sot këtu!"

## Ditë e paqte vëllazërie


Pas Kryegjyshit Botëror Bektashian, për të përrshëndetur besimtarët, fjala i jepet zj. Pavlina Evro, Konsulle e Republikës së Shqipërisë në Selanik. Ndër të tjera, ajo tha: "Jam e lumtur në radhë të parë që më jepet mundësia të përrshëndes sot ju të gjithëve, pjesëmarrës në këtë pelegrinazh sa të veçantë, masiv e shumë dobiprurës për mënyrën si organizohet dhe mesazhet e paqes dhe bashkëjetesës që ai përcjellë tek besimtarët, pavarësisht kombësisë apo vendit ku punojnë apo jetojnë. E prita me kënaqësi ftesën dhe me këtë rast dua të falënderoj në veçanti Kryegjyshin Botëror Bektashian, Hirësinë e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj që me aktivitete të tilla, krahas forcimit të lidhjeve shpirtërore të besimtarëve me Zotin, krijojnë një klimë miqësie, dashurie, solidariteti dhe paqe, aq të domosdoshme në kohët e vështira që po kalojmë sot. Është shumë domethënëse pjesëmarrja sot këtu e klerikëve bektashinj nga Shqipëria, Maqedonia Veriore, Kosova, Turqia etj, por dhe e klerikëve të besimeve të tjerë, pjesëmarrja e besimtarëve që flasin gjuhë të ndryshme e vijnë nga shtete të ndryshme, por që

reflektojnë dashurinë ndaj njëri-tjetrit dhe reflektojnë e pasqyrojnë ritet e traditat më të mira bektashiane. Historia e teqesë së 'Durballi Sulltanit', është një pjesë e historisë së artë por dhe të dhimbshme e të vështirë që ka kaluar ky besim ndër shekuj, ku nuk kanë munguar apo mungojnë ende dhe qasje të dhunshme të segmenteve shtetërorë, ekstremiste e dashakeqe. Por aktivitete të tilla, ku predikohet paqja e dashuria për atdheun, siç e ka dhe misionin besimi bektashian 'Pa atdhe nuk ka fe', ndikojnë në të mirë të gjithë shoqërisë. Dhe një herë ju falënderoj nga zemra!"

...Ndërkohë, pas ceremonisë, nisi dreka tradicionale, ku grupe-grupe, besimtarët shijojnë ushqimet e përgatitura, por dhe vazhdojnë bisedat e pafundme, nefeset dhe këngët e bukura bektashiane...

Shqetësimi i klerikut bektashian nga Turqia

Teksa bashkëbisedon me klerikë të tjerë dhe besimtarë të shumtë, kleriku bektashian Mahmut Erkin Ajdin, nxiton të komunikoj më gjatë me Kryegjyshin Botëror Bektashian, Hirësinë e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj. Ndjehet i ngazëllyer me pjesëmarrjen në këtë pelegrinazh, mënyrën e organizimit dhe mesazhet e paqes që ai përcjell, por nuk e fsheh dhe brengën që e mundon; pamundësinë që aktivitete të tilla të zhvillohen edhe në Turqi, për shkak të politikës atje. Tregon se jeton në Stamboll, por gjen kohë që shërbesën fetare bektashiane ta bëjë shtëpi më shtëpi tek besimtarët ilegalisht... Ai thotë dhe shpreson që Zoti ta sjellë sa më shpejt këtë ditë, teksa bashkëbisedon me Kryegjyshin Botëror: "... Megjithëse politika shtetërore e ka ndaluar





ushtrimin legalisht të fesë bektashiane në Turqi dhe rihapjen e objekteve të këtij besimi, ritet dhe tradita bektashiane ushtrohet nëpër shtëpi apo vende të tjera nga besimtarët, larg syve dhe veshëve shtetërorë, larg rrezes së 'anteneve' që shteti ka ngritur për të penguar lirinë fetare të miliona bektashianëve që jetojnë në këto troje. Besojmë tek Zoti se kjo ditë do të vij shpejt, por dhe ne duhet ta ngremë më fort zërin tonë... Ne, sytë i kemi sot tek Selia e Shenjtë, tek Kryegjyshi Botëror, Dede Edmond Brahimaj..." - pohon ai mes të tjerave.

## Për ringritjen e teqesë "Durballi Sulltan"

Rrënimi i teqesë "Durballi Sulltan", për shkak të mbylljes për shumë dekada, nuk mund të evitohej... Atë e shikon në shumë prej objekteve të saj të dikurshëm. Por ka filluar që të ringrihej... Është bërë rrethimi i plotë i saj, riparimi i tyrbes e disa mjediseve të veçanta, deri dhe tek mbajtja e mezareve e shtrimi i një segmenti rrugor që të sjellë këtu. Dhe të gjitha këto, nga emigrantët shqiptar që kanë ardhur në këtë zonë pas vitit 1990. Dhe të gjitha këto, me stërmundim, vuajtje e deri terror policor që arrinte

deri atje, sa deri para dy-tri viteve, nuk i linte besimtarët. Gjetëm mundësinë dhe biseduam gjatë me disa emigrantë besimtarë që kanë kontribuar gjithçka që është bërë deri tani për këtë teqe:

Vladimir Muratliu: "Jam 44 vjeç dhe jam nga Senica e Përmetit. Kam ardhur në emigrim këtu në Greqi vite më parë. Banoj familjarisht në Lamia. Kisha dëgjuar për teqenë famë mirë të "Durballi Sulltanit" dhe shpirti i besimtarit bektashian, më bëri që të vihem në kërkim të saj, bashkë me disa besimtarë të tjerë. E gjetëm e nuk e kishim larg. U mrekulluam që e gjetëm, por u brengosëm nga rrënimi i sajë. Që nga viti 2008, vija këtu, ndizja një qiri, merrja shpresë e besim tek i Madhi Zot, ikja për t'u rikthyer përsëri. Por nuk ka qenë e lehtë kjo. Policia nuk na linte ti afroshim objektit, na kërcënonte e shumë herë na shoqëronte e ndalonte. Por ne përsëri, këmbët na çonin tek teqeja jonë. E kjo u bë masive, sa që edhe policia e kishte të pamundur të na ndalonte. E ne, nisëm të vendosnim një gurë, të bënim një rrethim, të sistemonim tyrben etj... E besimtarët shtoheshin. Gjithçka nga munda e djersa jonë. Por ndjehemi të kënaqur, të lehtësuar për sa kemi bërë. E dimë se ka dhe shumë punë, e ne do i bëjmë. Takova sot Kryegjyshin Botëror, Dede

Edmondin, më përgëzoi, më uroj e më bekoj, më dha krahë... Kështu dhe shokëve të tjerë që kemi punuar e punojmë këtu. E shikoni sot këtë pjesëmarrje besimtarësh!?. Përherë e më shumë do të ketë në këtë vend të shenjtë..."

Agron dhe Namik Kadillari (vëllezër): "...Jemi nga Liqedhi i Skraparit dhe vijmë nga një familje me traditë të hershme bektashiane. Prindërit tanë kanë qenë myhipë. Kemi ardhur këtu që në vitin 2006 dhe jemi sistemuar mirë familjarisht. Jetojmë mirë me punën dhe djersën tonë. Sapo kemi ardhur e në vazhdim, kemi bërë e do të bëjmë sa mundemi për të rregulluar mjediset e kësaj teqeje bektashiane me famë. Që në javët e para kemi ardhur këtu familjarisht, e vijmë sa herë mundemi. Me paratë tona ndihmuam në rrethimin e mjediseve e territorit, si dhe rregulluam një segment rruge prej më shumë se një kilometër... Sot jemi shumë të lumtur. Ku janë parë këtu për shumë dekada kaq njerëz!?. Janë shqiptarë, grekë, turq, arabë etj... Vjen Kryegjyshi Botëror, na takon, përgëzon e bekon! Ku ka ditë më të lumtur për ne bektashinjtë në emigrim!?"

## Epilog

Mbrëmja po afron dhe besimtarët, me karvanë automjetesh e disa dhe në këmbë, nisen të largohen, të mbushur me shpresë dhe besimin në Zot... Aktori dhe poeti Sadush Ylli, teksa pohon befasinë për pjesëmarrjen e sivjetshme në këtë pelegrinazh, këmbëngul të evidentoj dhe rolin e Selisë së Shenjtë e posaçërisht të Kryegjyshit Botëror Bektashian, Hirësisë së Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj për punën e bërë në ringritjen e besimit dhe objekteve bektashiane jo vetëm në Shqipëri, por anë e kënd botës ku punojnë e jetojnë miliona bektashinj. P

or në këtë ndarje me urimin e ndërsjelltë "Zoti na ndihmoftë", ka dhe një 'pengesë', që jo vetëm të emocionon, por bën dhe krenarë këdo të pranishëm: Radhë të pafund grupesh e personash që duan të bëjnë një foto, të kenë një kujtim me Kryegjyshin Botëror... Kështu që zbrazjen e mjediseve të "Durballi Sulltanit", në këtë ditë të shënuar pelegrinazhi, e bën vetëm fshehja e diellit pas majëmalit...



## Selia e Shenjtë, në mision humanitar

Përpara disa ditësh, Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, shpërndau ndihma fëmijëve me aftësi të kufizuar e familjeve në nevojë.

Gjithashtu nën kujdesin e veçantë të Tij është bërë e mundur që gjatë këtij viti, të jepen një sasi e konsiderueshme ndihma humanitare për fëmijët me aftësi të kufizuar, shoqatave, familjeve në nevojë. Mëshirimi dhe humanizmi që mbart në vetvete besimi bektashian, ashtu siç thuhet në Kur'anin Famëlartë që, nga pesë shtyllat e Islamit, shumë e rëndësishme është dhënia e zekatit, si një obligim për klerikët dhe besimtarët bektashianë.

Në mënyrë të veçantë Kryegjyshi Botëror ka vijuar traditën e misionit humanitar në ditën e lindjes së tij duke u kujtuar të gjithëve se gëzimi shumëfishohet kur ndahet me të tjerët, sikundër brengat dhe hidhërimet zvogëlohen dhe zhduken kur ndahen me të tjerët. Po këtë ditë, ka qenë vetë Kryegjyshi Botëror, i cili shpërndau ushqime, veshmbathje dhe mjete të tjera mësimore dhe didaktike për fëmijët me sindromën "Doën" duke marrë me këtë rast falënderimet e sinqerta të personelit përkatës. Gjithashtu, ndihma të ndryshme në libra dhe ushqime u shpërndanë edhe për Institucionin e Riedukimit në Korçë, në Fier etj. Ndërsa çdo ditë në mjediset e Selisë së Shenjtë janë me dhjetëra njerëz në nevojë, të cilët marrin ushqim falas. Përvoja e Selisë së Shenjtë po shtrihet deri në teqetë bektashiane më të largëta të Shqipërisë.

Dhurata të ndryshme si dhe mjete mësimore dhe ushqime për fëmijët me sindromën Daën dhe të tjera. Gjithësesi, ndihmat e tjera vijuan me ushqime: për Drejtorinë e Burgjeve Korçë, për Fondacionin "Krah për Krah", për Shoqatën "Uninon Artistik Kombëtar Shqiptar", Shoqatës "Jetimi në fokusin tonë". Nga lagja "Ali Demi" gjatë vitit janë ndihmuar familjet në nevojë. Çdo ditë në mencën e teqesë rreth 20 persona hanë bukë. Kjo është mirësi dhe tradita bektashiane vazhdon, të ndihmohen të gjithë ata që janë në nevojë.

Koresp. "Urtësia"

# Të pathënat me Papa Franceskun

Në majin e tri viteve më parë, një ditë para takimit me Atin e Shenjtë, ne si delegacion bektashian, u pritëm në Vatikan nga peshkopi Augusto Guixot Miguel. Ajo që kuptuam që në krye të herës, ishte se kardinali në fjalë, donte të mësonte sa më shumë për bektashizmin jo thjeshtë nga pikëpamja doktrimore, se sa në rrafsh të mbijetesës epokale të besimit në vitet e errëta 1967-1990, kur feja u ndalua dhe me kushtetutë. Ai iu drejtua Kryegjyshit Botëror Bektashian, Hirësisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj duke i thënë se “kur ke Zotin në shpirt, je i fituar edhe atëherë kur të tjerët mendojnë se je i dënuar në vetminë tënde, apo në trishtimin tënd të madh.”

Kryegjyshi nisi të rrëfente se viti 1967 nuk ishte si një rrufe në qiell të kthjellët. Diktatura e kishte rrënuar dashurinë ndaj Krijuesit që në vitin 1945, atëherë kur shpalli programin e vet. Dora-dorës, u sanksionuan masa represive ndaj klerikëve dhe besimtarëve shqiptarë, duke kontrolluar çdo qelizë të jetës shpirtërore, për të mbërritur në aktin makabër, atë të rrënimit nga themelet të objekteve të kultit. “Shqipëria u rrethua me tela me gjemba, vijoi Kryegjyshi, por edhe në atë rrethim, ne besimtarët nuk u trembëm nga errësira. Ne e mbajtëm të gjallë besimin në Zot dhe ndofta kjo na bëri më solidarë dhe të bashkuar me njeri-tjetrin përballë dramës që po kalonim. Përpiqeshim të ishim së bashku, si bij të të njëjtit Zot, në gëzimet dhe hidhërimet e njeri-tjetrit, në mënyrë të fshehtë jetuam edhe me gëzimet që na falnin pashkët, bajrami apo dita e ashures.”

I kemi ndjekur, tha Miguel. Ne u çuditëm. Si na kanë ndjekur, si kanë mundur të marrin informacion për liritë tona të dhunuara kur në mes kishim një det aq të thellë!?. Ai vijoi: “Papa Vojtilla është lutur edhe për ju shqiptarët. Shumë pak e dinë këtë prej jush. Ose mund të dinë atë çfarë është kapur në eter prej Radio-Vatikanit, valët e së cilës mbulonin larg. Sado të lartë të kenë qenë telat tuaj me gjemba, Mbreti Krisht dërgonte prej andej fjalët e engjëjve. Ne të gjithë jemi lutur për ju.”

Në ditën e pritjes me Papa Françeskun, sipas protokollit të Vatikanit, ishim atje një gjysmë ore para. Na rrëfyan ku do uleshim, ku do ulej. Ati i Shenjtë dhe si do të vazhdohej më tej.

Papa Françesku doli në sekondën e duhur dhe me atë buzëqeshjen që ngroh edhe varfanjakun më të pashpresë, na takoi. “Bashkë njihemi, i tha Kryegjyshit Botëror, më bëhet qejfi që gëzon shëndet të plotë për vete dhe për gjithë bektashinjtë. Pastaj takoi z. Agim Zeka që u prezantua si gazetar dhe erdhi tek unë duke më mbajtur dorën në duart e tij. Kur unë i thashë funksionin dhe gjithashtu që kisha punuar si gazetar, më pyeti befas duke



**“Shqipëria u rrethua me tela me gjemba, vijoi Kryegjyshi, por edhe në atë rrethim, ne besimtarët nuk u trembëm nga errësira. Ne e mbajtëm të gjallë besimin në Zot dhe ndofta kjo na bëri më solidarë dhe të bashkuar me njeri-tjetrin përballë dramës që po kalonim. Përpiqeshim të ishim së bashku, si bij të të njëjtit Zot, në gëzimet dhe hidhërimet e njeri-tjetrit, në mënyrë të fshehtë jetuam edhe me gëzimet që na falnin pashkët, bajrami apo dita e ashures.”**

më parë në dritë të syrit: “Sipas jush, ku e kanë vendin gazetarët, në ferr apo në parajsë”. – “Në parajsë-iu përgjigja!” Ati i Shenjtë qeshi dhe tha: “Ah parajsja! Të gjithë e lakmojnë atë, por jo të gjithë e meritojnë!”. Ndërsa kur ishte koha për t’u ulur, Ati i Shenjtë, çuditërisht nuk ndenji në vendin e caktuar. Ai bëri me shenjë dhe dikush nga protokollit, i solli karrigen e thjeshtë afër nesh, duke shkurtuar distancën vetëm në dy-tri metra. Të gjendur kaq pranë, ne të gjithëve, na u larguan emocionet, ndërsa Ati i Shenjtë tha: “T’ia ndjejmë frymën njeri-tjetrit, ta shohim në sy, se jemi më pranë Krijuesit!”

Midis dhuratave që Kryegjyshi Botëror Bektashian i dhuroi atë ditë Atit të Shenjtë, ishte dhe një punim në argjend dhe mozaik që paraqiste familjen e bekuar të Profetit Muhamed, Ehli Bejtin. Duke ja dhuruar Papa Françeskut, për dy-tri minuta Kryegjyshi Botëror e bëri atë me dije, ç’përfaqësonte në të vërtetë ajo familje. Ati i Shenjtë, pasi dëgjoi me kujdes, e mori dhuratën në duar dhe po e shihte gjatë. Pastaj, duke na u drejtuar të gjithëve tha: “Ju falënderoj për këtë dhuratë. Duke respektuar pas kaq shekujsh familjen e bekuar të Profetit, në të vërtetë më jepet të besoj, se ju respektoni e adhuronin pa asnjë paragjykim, pa asnjë çmim, familjet tuaja bektashiane. Sidoqoftë, po e përsëris, se është e rëndësishme. Vlen t’i duam dhe ti respektojmë të gjitha familjet biologjike dhe shpirtërore të kësaj bote. Jemi të dënuar të jetojmë në paqe me njeri-tjetrin!”

**Syrja Xhelaj**

Meditim në 60 vjetorin e lindjes së Kryegjyshit Botëror Bektashian, Hirësisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj.

# Udhëtim në dy epoka

**C**do ditë e një jete të zakonshme, ka stacionet e saj nëpër udhëkryqet e kësaj bote. Ndërsa çdo ditë nga jeta e besimtarëve ka peshën e rëndë të përvujtësisë. Është pa kthim kjo përvuajtje, udhëton së toku me besimtarin dhe të dy së bashku kridhen në oqeanet e lumë të mëshirës, të urtësisë, të dashurisë paskaj ndaj Krijuesit. Një dervish, dikur e pat pyetur Bejazid Bistamiun e famshëm: “ Cili veprim mund të më afrojt më shpejt tek Allahu?” I urti Bistami e këshilloi: “Duaji robtë e urtë të Allahut! Duaj ata që të duan ty, dhe përpiku t’u hysh në zemra. Sepse Allahu sheh çdo ditë, 360 herë në zemrat e tyre dhe kur të shohë, të gjej edhe ty atje!”

Më jepet të mendoj se ka një lidhje të çuditshme (sigurisht jo në kohë fizike) midis sentencës së mësipërme dhe rrjedhave aspak të qeta të jetës së baba Mondit. Ndenjat e urtësisë dhe të dashurisë së tij për njerëzit në përgjithësi, kanë plazmuar afreske të mrekullueshme shpirtërore. Receptorët e ndjeshëm të pranive hyjnore, kanë bashkuar atë në udhëtimin 60 vjeçar me mijra fate të tjerë njerëzorë, duke dhënë e marrë mesazhe paqeje të ndërsjellët, për të dalë sa më shpresëplotë në bregun tjetër. Një ndërveprim kaq kozmik i fateve njerëzorë, ka dashur të ketë kurdoherë një lloj drite të pashmangshme, në çdo rrahje zemra, në çdo moment dhe hapësirë, e përfutur sa

nga mirësia dhe devocioni i të tjerëve, aq edhe nga ndjenjat e përljes të besimtarit ilegal të dikurshëm dhe Kryegjyshit Botëror të sotëm. Një lidhje unike e tillë e baba Mondit me besimtarët, veç të tjerave na sjell ndërmend traditën e vyer bektashiane ku myrshidi dhe myridi marrin frymë, përmes një shpirti të vetëm.

I lindur 60 vite më parë, ai do t’u bashkohej lodrave të fëmijëve tiranas, me kontrastet e gëzimit të atyre kohrave. Në atë betejë donkishoteske për të instaluar komunizmin libror, mekanizmat shtetëror ishin shumë të kujdesshëm në “edukimin” e fëmijëve në kopshte e shkolla, duke u vetëmburrur madje për krijimin e njeriut të ri. Perceptimet shtetërore konvergonin në idenë naive se, sa më i kontrolluar të ishte shpirti njerëzor, aq më lehtë ai do të drobitej dhe lodhej në tallazet ideologjike për t’u dorëzuar përfundimisht në duart “e ngrohta” të Partisë. Prandaj edhe bjerrja shpirtërore do të ishte e pashmangshme, duke ia lënë vendin zbrazëtirës së frikshme.

Gjithsesi përtej këtyre kalkulimeve të ftohta ateiste, në fëmijërinë e Edmond Brahimat, do të shfaqeshin edhe disa galaktika, drita e të cilave, ndonëse diçka e mekur dhe e largët, nuk do të shuhej në horizont gri të jetës njerëzore. E para lidhej me udhëtimet e tij verore, në Brat, ku veç lisave dhe ujit të ftohtë të maleve, hasje rëndom në histori dervishësh dhe

baballarësh bektashianë, të cilët ndonëse u përndoqën aq egërsisht pas vitit 1967, u ruajtën gjatë në memorien dhe shpirtin e besimtarëve. Këto “bëma” gjithmonë të urta të klerikëve bektashianë, shpesh herë u afroreshin miteve dhe duke u përcjellë nga goja në gojë, nga fshati në fshat, merrnin trajtat e tyre dhe zinin kreun e vendit në muhabete burrash. Fantazmagoria që i shoqëronte këta mite nxirrte në pah, diku Haxhi Bektash Veliun, udhëheqësin shpirtëror të tarikatit, diku tragjedinë e Qerbelasë dhe kryetrimin Imam Hyseni, paqja qoftë mbi të, diku Ballëm Sulltanin apo baballarë të tjerë, të cilët gjithsesi rrethoheshin prej një velloje misteri dhe dashurie së bashku.



**Jeta baritore dhe kodet e pashkruara zakonore të Bratit, do të linin në lartësinë më të epërme, gjurmët e tyre në fëmijërinë e Edmond Brahimajt. I gjithë ky univers mitesh dhe ritesh, lidhej padyshim me Idriz Avdylin, gjyshin e Edmond Brahimajt nga i jati, i cili pat bërë emër në trevën e lumit të Vlorës, për drejtësinë dhe urtësinë proverbiale.**

Qysh herët, kur dede Ahmet Myftari, njeriu shumë pranë familjes së tij, mbeti jetim, Idrizi jo vetëm ndau më të kafshatën e bukës, por edhe u kujdes që dhimbja e këtij jetimi të zbuteshin sadopak përmes një mirësie që Zoti i Lartë, pat mbjellë në shpirtrat e njerëzve të atyre anëve. Idrizi dhe Hatixheja ju gjenden pranë dede Ahmetit në çastet më të vështirë të Luftës së Dytë Botërore, duke i kujtuar atij se familja biologjike është shumë e madhe, shkon përtej motrës dhe vëllait, nënës dhe babait. A mund të ketë shërbyer ky fakt për një lloj paralelizmi midis familjes biologjike dhe asaj shpirtërore në vetëdijen e klerikut të ardhshëm? Ndoshta! E vërteta është se disa vite më pas, me hyrjen e dede Ahmetit në vargun e ndjekësve të devotshëm të Haxhi Bektash Veliut, Idriz Avdyli mori dorë menjëherë tek ai, i qetë në ndërgjegje për gjithçka kish bërë dikur për një jetim. Sigurisht që ai nuk mund të ndante me të nipin, Edmodin 8-9 vjeçar, sekretet e mejdanit, por kjo nuk do të thoshte që ky burrë i mençur, të mos prodhonte shkëndija besimi në Zot, siç bënte me uruar dhe eshkë, për të ndezur çibukun prej bushi të Bratit.

Në vitet që rrodhën më pas, në shtëpinë e vogël me dy dhoma e guzhinë në pallatet në periferi të Tiranës, befaz një natë u suallën dy divane të thjeshtë prej dërrase dhe fëmijët e Hysenit dhe të Merushes mësuan se aty do të vinin kur të donin, dede Ahmeti dhe dervish Reshati. Askush prej fëmijëve nuk kish të drejtë të hynte brenda në atë dhomë, ndonëse

në bravën e saj nuk kishte çelës. Mos vallë po vinte ora? Në mistikë, engjëjt e zbritur nga prania hyjnore, vrapojnë me krahë ere për të arritur zemrën. Por jo zemrën fizike, natyrisht, por atë... fronin e Tij. Çuditërisht është përcaktuar se krejt gjithësia, është tepër e ngushtë për të nxënë Zotin, ndërsa zemrat e bijve të Ademit janë aq të gjera sa mund të shndërrohen në fron të Tij. Gjerësia dhe thellësia e këtyre zemrave janë të papërceptuara prej çdo mekanizmi lëndor apo elektronik. Ne nuk dimë se kush jemi në të vërtetë, nga kemi ardhur dhe ku duhet të shkojmë, derisa vjen dita që Krijuesi, i Gjithëdijshëm na jep çelësat për të hapur zemrat. Së pari këtë çelës Allahu i Lartë ja dha Profetit tonë të bekuar. Ky burrë i merakosur për ymetin e tij, pyeti nëse do t'ua jepte çelësin edhe atyre. Atëherë erdhi kumti: "Nëse ata ndjekin hapat e tu, e kanë këtë fitore. Ata nuk janë të privuar apo të penguar nga arritja e saj. Gjithçka që të është dhënë ty, o i dashuri Muhamed, paqja qoftë mbi ty, është edhe për popullin tënd!"

Për çdo nxënë të shkollës së mesme ushtarake



"Skënderbej" në vitet 70 të shekullit që lamë pas, ajo portë e madhe jeshile, në hyrje të së cilës qëndronte vetullngrysur ushtari i shërbimit të radhës, ishte gjithçka. Madje jo rrallë përfytyrimet e skënderbigasve nuk kishin të mundur të depërtonin brenda heshtjes kryeneçe të saj, ku duhej të studioje deri në imtësi artin ushtarak popullor. E vërteta është se gëzimet dhe shpresat, ëndrrat dhe vrulli rinor i atyre 16-17 vjeçarëve derdheshin si ajo llava e nxehtë në kallëpet e rregulloreve ushtarake, duke dashur të ndërtonin modelin e oficerit "të lavdishëm", të atij që duhej të përballonte i vetëm, gjithë ushtritë moderne të botës. Skënderbegasi Edmond Brahimaj, ndryshe nga të tjerët, nisi t'i kalonte më "ëmbëlsisht" situatat luftarake. Muret e lartë të shkollës, rregulloret, disiplina e rreshtit, monotonia e orëve edukimit politik, të gjitha këto, ishin lehtësisht të kapërcyeshme. Për të, mbetej imediate të kapërcente muret e lartë të besimit, për të parë se ç'bëhej brenda shpirtit njerëzor të dhembshur edhe në ata vite të thatësirës ateiste.

Prej dy patriakëve bektashianë, dede Ahmet Myftarit dhe dervish Reshat Bardhit, skënderbegasi Edmond Brahimaj ka marrë shumë leksione. Sigurisht ndër të parët, ka qenë leksioni i madh se Zoti nuk e do luftën. Përkundrazi Ai lutet për mëshirë dhe paqe për të gjithë. Kjo inkoherencë filozofike do ta largonte disi Edmond Brahimin nga dëshira për karrierë ushtarake, e cila në rastin e patriotëve të tij, (vlonjatëve) çuditërisht ishte shndërruar në anekdotë. Së këtejmi, nga kjo zvenitje shkollore, mendoj se ka buruar edhe ndjeshmëria dhe zelli i tij, për t'u endur në të dy universet, sa në atë ushtarak aq edhe fetar. Sigurisht kredhja në universin e parë, të jepte komoditetin e të shfletuarit të librave me karakter ushtarak, shkencor apo politik, në klasa e biblioteka, në kabinete ku mendohej se do të sendërtohej karakteri i çeliktë. Diçka e domosdoshme kjo brenda absurdit të madh. Ndërsa ecja nëpër universin tjetër, atë plotësisht ilegal, brenda mistereve me një barrë të frikshme rreziku me vete, që të kujtonte çantën e shpinës në marshime, sipas modeleve tradicionale të etërve bektashianë do të ishte diçka e mrekullueshme.

Pas kalimit nga kjo botë e dede Ahmet Myftarit, mali i vetëm i besimit, atje ku u mbështetën për vite radhë bektashianë nga e gjithë Shqipëria, ishte dervishi i tij, Reshat Bardhi, një ndërthurje në harmoni të plotë

e qëndresës tradicionale veriore me shpirtin e madh dhe vizionin pa skaj të klerikut. Tek ky mal mbështeti kokën Edmond Brahimaj, duke kapërcyer vështirësitë fizike të jetës universitare ushtarake, dhe duke ndarë përmes dhimbjesh të pandërprera të jetës e tij, në dy gjendje emocionale. Nëse ditët në universitetin ushtarak ishin plot marshime, privacione të lirisë së vërtetë, situata luftërash imagjinare, që vetëm në shqiptarët i imagjinonim me aq konkretësi donkishoteske, ku ato fashiteshin dhe vinte muzgu, studenti "harrakat" kapërcente muret e asaj jete dhe kalonte orë të tëra me dervish Reshatin. Një botë tjetër shfaqej sakaq dhe gjeneralët më të lavdishëm të luftërave në botë, dukeshin si hije përballë "bëmave" të dervishëve të Haxhi Bektash Velit.

Ndërsa kur në dyert e Shqipërisë trokiti liria e vërtetë, oficeri Edmond Brahimaj nuk hezitoi aspak. Ai bëri një kërkesë sipas rregullave ushtarake dhe ua drejtoi pikërisht atyre që i patën "tërhequr veshin", se duhej të merrej me strategjinë e luftës dhe jo me përralla dervishësh. Ai nuk i qesëndisi të pafetë, nuk u kujtoi askurrë çfarë i patën thënë, as çfarë i kurdisnin pas shpine. Ai heshtëte duke ndjerë se ishte shumë pranë asaj që kishte ëndërruar. Profeti Muhamed a.s u pat thënë dikur miqve të tij të afërt: "Beto hem në Allahun që ka në dorë frymën time, se, nëse nuk keni mëshirë për njeri-tjetrin, nuk do të hyni kurrë në kopshtet e xhenetit." Po këta, i thanë se ne jemi të gjithë të mëshirshëm me ata që njihnin. Atëherë Profeti ynë vijoi: "Mëshira për të cilën ju thashë nuk është siç e kuptoni ju, vetëm për njeri-tjetrin, përkundrazi është mëshira që i përfshin të gjithë krijesat.." (Hakim, Mustedrek, IV, 185)

I përfshirë në të gjitha ngjarjet më të rëndësishme të ringritjes të bektashizmit pas vitit 1991, Kryegjyshi i sotëm Botëror, do të ecte optimist në atë udhë të çelur me aq dashuri nga të parët e tij, nga prindërit biologjik e mandej nga ata shpirtëror. Udhëtimi i tij



shpirtëror tani do të shtrihet në dy epoka që, ndonëse në pikëpamje filozofike kundërshtuan njëra-tjetrën, në atë shpirtërore do ta plotësojnë atë. Të gjashtëdhjetë vitet mbi supë, veç të tjerave, mbeten provë e një stoicizmi tradicional bektashian, ku shpesh aspiratat janë mbrojtur jo vetëm me shpirtin por edhe me jetët fizike të klerikëve. Ndërsa vëllazërimi unik i tij me tarikatit dhe misticizmin e çlirët, janë provë e kapërcimit të sfidave të sotme dhe të nesërme. Besoj se jemi shumë sot, anekënd botës, që bashkohemi në urimin për një jetë sa më të gjatë të Kryegjyshit, në shërbimin e përvuajtur ndaj Zotit, imamëve, erenlerëve dhe besimtarëve. Paqe në shpirtira. Amin!

Syrja Xhelaj

# Bektashizmi si mishërim i paqes



**Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj, merr pjesë në Forumin Ndërfetar për Liritë Fetare, në Bruksel**

**M**e ftesë të organizatorëve të Forumit Ndërkombëtar European, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj, mori pjesë më 20 qershor të vitit 2019, në seancën plenare për sfidat e sotme të lirisë fetare. Në këtë seancë merrnin pjesë lider të feve të ndryshme, deputetë europianë si dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme ndërkombëtare etj. Liria e ushtrimit të besimit fetar, perceptimet dhe mënyrat se si kjo liri përcillet konteksteve të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, aspektet ligjore dhe morale në mozaikun e besimeve, do të ishin disa nga çështjet e shtruar në seancën në fjalë, ku edhe diskutimi i Kryegjyshi Botëror Bektashian, solli disa konkluzione interesante. Përvoja e diskutimeve të tilla, u tha nga organizatorët e kësaj seance të Forumit Ndërfetar European, duhet bërë e qartë për të gjithë dhe duhet shtrirë deri në komunitetet fetare më të largët.

Më pas, në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga zyra europiane e kishës, për shkencën, të drejtat e njeriut dhe çështjet publike, të pranishmit ndoqën me vëmendje diskutimin e Kryegjyshit Botëror Bektashian, në lidhje me doktrinën bektashiane, sfidat dhe roli i saj në Ballkan, Europë e më gjerë. Në këtë diskutim që zgjati rreth një orë, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj, tha midis të tjerave: “Kam kënaqësinë e veçantë të ndajmë së bashku kohën në dispozicion për të bashkëbiseduar në lidhje me tarikatën që përfaqësoj dhe më lejoni së pari t’ju uroj dhe bekoj në emër të miliona besimtarëve bektashinj në gjithë botën: “Paçi bekimet e Allahut, paçi ndihmën e Muhamed Aliut për ju dhe krejt familjet tuaja!”. I lindur gati 800 vjet më parë, tarikati bektashian pati fatin e madh të ketë themele të shëndoshë dhe të fuqishëm në Azinë e asaj kohe. Padyshim, ndër elementët më bazikë dhe të rëndësishëm të këtij themeli, në esencë të këtij

besimi, ka qenë dhe mbetet urtësia e themeluesit Haxhi Bektash Veliu, i cili e mëshiroi shenjtërinë emblematike të tij, vetëm e vetëm përmes devocionit ndaj Krijuesit. Besoj se të gjithë ne, që jemi sot këtu, ndajmë së bashku se dija e thellë është vlerë për urtësinë, por jo gjithçka. Vetëm kur dijes i bashkohet devocioni në fe, lufta pa ndërprerë ndaj gjërave të përkohshme të kësaj bote, mërgimi prej egos, si dhe agjërimi në shkallët më të epërme të tij, atëherë nënkuptojmë vetë urtësinë. Trualli në të cilin u lind dhe u rrit tarikati islam i bektashizmit, nuk ishte si një tokë korriku e plasaritur nga dielli që pret shiun me padurimin e vetë ekzistencës. Në këtë tokë kishte barë dhe lule, kishte ferra dhe gjemba, kishte drurë shekullorë dhe hijerëndë krejt indiferentë ndaj tarikateve që lindnin. Por fidani i bektashizmit erdhi duke u rritur fuqishëm, pikërisht se ishte mëkuar nga urtësia e Haxhi Bektash Velikut dhe u vadit paskëtaj me ujërat e kthjellëta të Ehli-Bejtit si dhe devocionin e dervishëve dhe baballarëve. Si rrallëkund në kontekstet fetare, klerikët bektashinj e identifikuan veten dhe veprën e tyre me lindjen dhe rritjen e një vëllazërie të pandashme brenda komunitetit. Është gati unikale në botën fetare, të djeshme dhe të sotme, perceptimi në bektashizëm që lidhet me ndjekësit e tij parësorë, ata më të devotshmit që në gjuhën e përditshme quhen “muhiban”. Sipas kodeve zakonore të sufizmit, këta praktikantë, në natën e caktuar prej udhëheqësve shpirtërorë, duhet patjetër të celebren përmes bekimit në mejdanin e teqesë, në prani të djemve apo vajzave të tjera, të cilat deri në ato çaste, mund të mos i ketë njohur fare. Zakonisht në mejdan, ne klerikët bektashianë celebromë shumë anëtarë spiritualë, që vijnë prej krahinash të ndryshme, apo etnive të ndryshme. Aspekti ceremo-

nial sigurisht ka vlerat e veta në këtë rast. Por ajo që mbetet e shenjtë në mejdanin e teqesë është pikërisht fakti që djemtë dhe vajzat, gratë dhe burrat që marrin titullin e “myhibanit”, në jetë të jetëve janë vëllazër apo motra të njeri-tjetrit, në mënyrë pak a shumë të ngjashme me elementët e pagëzimit në krishtërimin ortodoks. Myhibanët tanë mbesin motra e vëllazër, me të njëjtat detyrime që rrjedhin prej familjes biologjike.

Vlerat e këtij vëllazërimi kanë qenë dhe mbeten të dukshme, sidomos në viset ballkanike qysh kur u ngritën teqetë e para në shekullin e trembëdhjetë dhe deri në ditët e sotme. Për vetë kushtet gjeografike, strategjike, historike dhe fetare, Ballkani ende sot identifikohet me dyfjalëshin: Fuçi baruti! Pikërisht ky ka qenë edhe misioni kryesor i tarikatit bektashian, të ushqejë lidhjet e besimit, të ngrejë ura paqeje dhe shprese me idenë se jemi bij të një Zoti të vetëm dhe jemi të destinuar të jetojmë së bashku në këtë tokë e nën këtë qiell. Teqetë bektashiane, qysh në mesjetën e hershme dhe deri më sot janë streha të paqes shpirtërore dhe asaj fizike. Dyert e tyre kanë qenë dhe mbeten të hapura ditë dhe natë, jo vetëm për besimtarët tanë por edhe për çdo besimtar syni, të krishterë, hebre apo besimeve të tjera. Janë me dhjetëra udhëtarë e studiues të huaj



si: Justin Godard, Edit Durham, Andrea Karkavitsas, Teodor Ipen, Margaret Hasluk, Noell Roger, Luis Zharej, Franc Babinger, Jashar Rexhepagiq, Roberto Moroko dela Roko, Nuraj Bozboore dhe deri tek Francez Trix nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilët kanë vlerësuar jo thjeshtë mikpritjen në teqetë bektashiane, por edhe intelektin e çmuar dhe mirësitë që klerikët tanë kanë falur me aq dashuri dhe çiltërsi. Një meritë e padiskutueshme e kombit tim shqiptar, është gjithashtu përkrahja që i dha tarikatit bektashian në një prej ditëve më të vështira të tij, në fund të viteve 20 të shekullit të kaluar, atëherë kur pas reformave sekulariste në Turqi, tarikateve në tërësi po u merrej fryma. Në ato kushte mbijetese, dervishët dhe baballarët e Shqipërisë, i afruan vëllazërinë e tyre emblematike ish-Kryegjyshit Botëror Bektashian, Sali Niazi Dedesë jo vetëm duke e pranuar në gjirin e tyre, por edhe duke kontribuar me çdo mjet për ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave më të spikatura të tarikatit. Ata e kuptuan se ora e madhe e historisë së bektashizmit po binte për 'ta, ndaj edhe mbajtën mbi supet e tyre përgjegjësinë e vazhdimësisë. Sot e kësaj dite, edhe ne klerikët bektashianë aktualë, kudo ku jetojmë e punojmë, përpiqemi të transmetojmë tek brezat dashurinë e thellë për Krijuesin, përdymbëdhjetë imamët, për atdheun dhe familjen, duke e shndërruar forcën e tarikatit në energji paqeje të vetëdijshme. Për bektashinjtë e të gjitha kohërave, sufizmi në thelb është udha që i drejton besimtarët drejt stacioneve hyjnorë të tyre.

Në të vërtetë, teoritë e sotme për sufizmin janë të shumta, por ata konvergojnë ekzaktesisht në një pikë: tarikatit është udha për në hapësirat e qiejve, është udhëzues korrekt dhe i ndjeshëm drejt përsosjes shpirtërore. Madje në vetëdijen tonë është ngulitur fort ideja se vendlindja e trupave tanë fizik është kjo botë, ndërsa vendlindja e shpirtit tanë, bota shpirtërore. Të shpërndarë më shumë se në 31 shtete, ne sot ecim me milionat e besimtarëve përmes kohërash aspak të përshtatshme për besimin. Por kjo nuk na ka trishtuar asnjëherë. Ne jemi përpjekur të shpalosim identitetin tonë fetar brenda familjes së madhe të Islamit, duke ndërtuar ura lidhje dhe besimi jo thjeshtë për krenari, por për të dhënë kontributin e mundshëm në Shqipëri, në Ballkan dhe më gjerë në Europë, të bindur se mes nesh dhe të tjerëve kemi mijëra gjëra që na bashkojnë dhe asgjë që na ndan. Identitetet fetarë, dhe kulturorë diversë, përpiqemi t'i shohim me sytë e shpirtit dhe kjo na bën t'i afrohem tjetrit si vëllait tonë biologjik. Tek e fundit, familja e madhe europiane pikërisht këtë kërkon: vëllazërimin e pjesëtarëve të saj."

Në ditën tjetër të forumit në fjalë, i ftuar nga drejtuesi i kanalit televiziv "Europa e Re", z. Andrianos Giannou, Kryegjyshi dha një intervistë të gjatë, duke u përpjekur të paraqesë në mënyrë më konkrete dhe të detajuar ndryshimet me të cilat përballet sot tarikatit bektashian. Pyetjes së Giannou lidhur me vizitën në Bruksel, ky iu përgjigj: "Ftesën nga Brukseli e prita me kënaqësi të veçantë. Ne kemi pasur në vijimësi takime të rëndësishme në Europë, por kur bëhet fjalë për seanca plenare apo dëgjimore nëpër komisione të ndryshme të Parlamentit Europian, çështjet marrin rëndësi të veçantë. Falë përpjekjeve tona të përbashkëta, ne kemi mundur të regjistrojmë komunitetin bektashian në Regjistrin e Transparencës të Parlamentit dhe të Komisionit Europian. Ne mendojmë se është tejet e rëndësishme të ndajmë përvojat, me bindjen e thellë se këto do t'i shërbejnë qëllimit të përbashkët, bashkëjetesën vëllazërore. Si lider i Selisë së Shenjtë Bektashiane unë përdor çdo mundësi për të dialoguar dhe komunikuar në përcjelljen e vlerave më të spikatura të harmonisë fetare në Shqipëri si dhe rolin e bektashizmit. Ne vlen të sjellim këtë përvojë pse realisht jemi pjesë e qytetërimit europian dhe duhet të shkojmë në Europë përmes dinjitetit tonë fetar, etnik, moral dhe kulturor.

Pyetjes së z. Giamou, lidhur me problemet e sotme të komunitetit bektashian në Maqedoninë Veriore, Kryegjyshi Botëror iu përgjigj: "Është e vërtetë. Jo vetëm ne, por krejt komuniteti ndërkombëtar ndjekin me shqetësim situatën e teqesë sonë në Tetovë, të uzurpuar prej 20 vitesh nga disa ekstremistë. Një vit më parë, Gjykata e të Drejtave të Njeriut në Strazburg, na njohu ligjërisht të drejtën e regjistrimit të komunitetit tonë si institucion fetar. Ndonëse ka kaluar një vit nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, autoritetet shtetërore përkatëse të Maqedonisë Veriore, ende nuk e marrin në konsideratë këtë realitet. Përgjatë këtyre viteve ne kemi bërë përpjekje të shumta fetare, diplomatike, shtetërore për të fituar të drejtën elementare të ushtrimit të besimit, por pa rezultat konkret. Jemi ballafaquar ndërkaq edhe me forma të diskriminimit dhe përndjekjes, deri tek dhuna fizike. Ekstremistët na kanë kërcënuar, dhunuar dhe deri na kanë djegur disa mjedise te teqesë. Pavarësisht kësaj dhune, ne u jemi përgjigjur me gjakftohtësi e logjikë qytetare. Ligje dhe vendime të ndryshme të dala nga Qeveria e Maqedonisë Veriore, janë përpjekur të anashkalojnë komunitetin tonë dhe kjo është paradoksale. Si mund të privohen të drejtat fetare mijëra besimtarëve bektashianë? Si mund të mohohet prania fizike e shpirtërore e një teqeje bektashiane, e cila ka të dokumentuar praninë

dhe misionin e sajë fizik dhe shpirtërorë 500 vjeçar në Tetovë?

Ne nuk mund t'u përgjigjemi ekstremistëve me ekstremizëm. Në esencë të besimit tonë 800 vjeçar është vëllazëria. Bektashizmi ka ardhur në këtë botë si mishërim i shenjtërisë së paqes, ndaj dhe ne jemi të sigurt se me shpirtin tonë të paqhtë, me ndihmën e forcave më të përparuara europiane si dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, do të mundim të keqen që na mbinë nëpër teqe, siç na mbijnë barërat e këqija në kopësht. Ne kemi qenë dhe mbetemi të hapur për dialog sepse e konsiderojmë çdo lloj bashkëbisedimi si udhë për të kapërcyer meritë, qofshin këto me karakter fetar, etnik apo moral. Barazia është një model i ndjekur prej bektashinjve qysh në dhjetëvjeçarët e parë të zhvillimit të këtij tarikatit. Ne jemi po kaq të barabartë dhe në familje, ku gruaja ka vendin që meriton, e denjë të ecë pa asnjë kompleksitet ndaj civilizimit perëndimor. Përkundër disa shfaqjeve në shoqërinë shqiptare, gratë shqiptare nuk janë mbuluar asnjëherë me hixhab, madje ne klerikët predikojmë nëpër teqe veç të tjerave, një sjellje sa më dinjitoze ndaj nënave dhe motrave tona. Ata janë shtylla të familjes dhe respekti ndaj tyre është detyrë e të gjithëve.

Ndërsa pyetjes së Giannou, se kush mund të jetë 'sekreti' i bashkëjetesës fetare në Shqipëri, Kryegjyshi iu përgjigj: "Së pari, ne na ka bekuar Zoti të respektojmë të gjitha besimet, të gjithë librat e shenjtë, të gjitha doktrinën që rrjedhin prej tyre. Përkatësia fetare: bektashi, ortodoks, katolik, syni, protestant apo çdo besim tjetër, për ne ekziston vetëm në sensin se si t'i respektojmë sa më mirë ritet e praktikat e tyre. Për mua person-

alisht, të gjithë jemi vëllazër dhe gjithçka na bashkon, për të mos na ndarë asnjë. Shiko, të gjithë, ne, Zoti na ka pajisur me pesë gishtërinj në çdo dorë. Të ndarë, ata nuk kryejnë asnjë funksion. Të pestë bashkë, bëjnë mrekulli. Besoj se prandaj kemi ardhur në këtë botë të dallueshëm nga njeri-tjetri, që ta ndihmojmë njeri-tjetrin dhe jo ta luftojmë. Ka njerëz-mjeranë që kujtojnë se kanë armiq. Jo, për mua, armiku më i madh tek çdo njeri, është ego e tij. Ne jemi krijimi më i bukur në tokë, por fatkeqësisht e lëndojmë njeri-tjetrin, për shkak të egos sonë. Ne vlen të përsosemi çdo ditë, pikërisht duke u largua nga ego jonë. Kjo luftë e përbashkët, historia e përbashkët e komuniteteve fetarë në Shqipëri, ka bërë që harmonia fetare të konsolidohet dhe tejkalohe në 'vëllazëri fetare', siç ka cilësuar Papa Françesku.

Gjithashtu, gjatë ditëve të zhvillimit të këtij aktiviteti, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, u takua me : Dr. Miro Kovaç, Drejtor i Komitetit për Punët e Jashtme në Parlamentin e Kroacisë. Dr. Jose Luis Bazan, përfaqësues në Konferencën Episkopale të Komunitetit Europian, Juri Aluis përfaqësues i Ambasadës së Republikës së Indonezisë në Bruksel, Thierry Valle, President i asosacionit për liritë fetare në Francë, Dr. Marco Respinti drejtor i të Drejtave të Njeriut dhe Lirisë së Besimeve në Kinë, z. Raphael Earlin, përfaqësues i aksionit për të drejtat e njeriut në Bruksel etj. Në këto biseda u diskutua përveç të tjerave për misionin bektashian të sotëm në rrjedhat e zhvillimeve fetare, si dhe përgjegjësinë e kontributin e spikatur të Selisë së Shenjtë Bektashiane.

Koresp. "Urtësia"



# Emocion: Pelegrinazh në teqenë e Gjakovës



Urat fizike, të bllokuara jo rrallë në dekada e shekuj nga tendencat lakmitare të pushteteve, persekutimi absurd ndaj klerikëve e besimtarëve bektashianë në të dy anët e kufirit dhe kazmat e urët e zjarrit në duar të të pafeve mbi objektet e shenja të kultit, mundën ti mbajnë të ndarë fizikisht besimtarët, por jo dashurinë e pakufishme tek Zoti dhe shpresën se një ditë ata do të jenë së bashku, pranë njeri-tjetrit, në zakonet dhe ritet e besimit të paqtë të bektashian. Tashmë, kufiri fizik që ende ekziston, pothuaj ka vetëm dukurinë e formalitetit... Kështu ka ndodhur dhe ditën e 14 korrikut të këtij viti me fluksin e pafund të besimtarëve bektashianë nga treva të ndryshme të Shqipërisë që kanë marrë udhën për në teqenë historike të Gjakovës, në ditën e pelegrinazhit vjetor. Janë nisur në orë të ndryshme të kësaj dite nga Vlora, nga Tirana, nga Kruja, nga Elbasani etj, për të qenë së bashku që në mëngjes në mjediset e teqesë. Por ka jo pak që këtë rrugëtim e kanë marrë që një ditë më parë... "Ne jemi një grup që jemi nisur që në orën 05:00 të ditës së djelë për në Gjakovë. E kemi bërë këtë rrugë pothuaj çdo vit, që pas ndryshimeve politike në Shqipëri në vitin 1990. Unë kam ardhur familjarisht. Ndjejë emocion e shpresë sa herë vij këtu... Ndjej atë që ndjejnë të gjithë besimtarët bektashinj kur vijnë në

vendet e shenja, por unë kam dhe ndjesinë e veçantë. Baba Qamil Bakalli që ka shërbyer e ka lënë gjurmë në teqenë e Gjakovës, është strehuar në familjen tonë." - pohon mes të tjerave Qamili nga Kruja. Kanë ardhur gjithashtu besimtarë dhe nga qytete e krahina të tjera të Kosovës, nga Tetova, Shkupi, Gostivari etj.... Baba Munimi, ashtu i menduar e plot mirësi, i pret dhe uron një nga një të gjithë ata që kalojnë pragun e teqesë. "Nuk ka njoftim për këtë ditë. Nuk kemi çuar ftesa. Por njerëzit vijnë pa pushim e nga do për të kaluar së bashku këtë ditë të shënuar, këtë ditë pelegrinazhi. Vijnë me plot dëshirë, llafosemi së bashku, i falemi të Madhit Zot e mbushemi me shpresë e besim për më shumë urtësi, paqe e mirësi..." - pohon baba Mumini. Ashtu, duke kuvenduar me grupet e besimtarëve dhe miq e zyrtarë të pranishëm, baba Mumini gjen kohë që të kujtoj dhe ato dit të vështira të vitit 1999, kur pushtuesi serb e dogji këtë teqe, shkatërroi e shkrumboi dhe literaturë e një pasuri dokumentare tejet të rrallë, e cila e ka pikënisjen që nga viti 1970, kur u themelua kjo teqe. "Ne bektashinj, në historinë tonë 800 vjeçare, kemi kaluar vështirësi nga më të shumtat, deri dhe çnjerëzore, por besimi në Zot, udha e Haxhi Bektash Veliut dhe misioni i shenjtë i besimit tonë, na ka bërë që të ringrihem e të bëhemi më të fortë. Por viti 1999, si pasojë e mllef

shovnist serb, shkaktoi pasoja të rënda në teqenë tonë. Kjo teqe që daton afro dy shekuj e gjysmë nga themelimi u dogj e u rrënuar. Mbi të gjitha, u dogj një pasuri e vyer dokumentare, mbi të gjitha, disa dorëshkrime, 58 gjithsej që kishin seicili nga 100 deri në 400 faqe. Humbje e madhe, por ne mbijetuam e do mbijetojmë, duke u shtuar përditë e më shumë. E ringritëm teqenë dhe mblidhemi sot e për mot kështu, me dashuri vëllazërore, me besim e përunjësi tek Krijuesi i Plotfuqishëm" - shton baba Mumini.

Në bisedë e sipër, në një moment ndërhyr dhe një besimtar... Na thotë se quhet Fatos Dede e banon fare afër teqesë, në rrugën që mbanë emrin e klerikut të njohur Qazim Bakalli. Aktualisht është nëpunës i urbanistikës në njësinë vendore të Gjakovës. "Baba Qazim Bakalli, si kudo ku ka qenë, në teqe të ndryshme në Shqipëri e vende të tjera, ka lënë emrin e mirë dhe shembullin e klerikut të përkushtuar në udhën e Haxhi Bektash Veliut dhe në dashurinë e pakufishme për vatanin. Ai ka jetuar gjatë në familjen tonë. Unë kam privilegjin që baba Qazimi të më vendosë emrin që kam dhe sot. Në këtë teqe, në këtë shtëpinë tonë të bektashinjeve, ne do të vijmë dhe do shtohemi brez pas brezi. Kjo shtëpi e Zotit na mbanë gjallë, na jep shpresë- shton mes të tjerave ai.

Natyrshëm, besimtarët e pranishëm mblidhen në sheshin para teqesë në ceremoninë e thjeshtë e domethënëse të ditës së pelegrinazhit. Baba Mumini, në fjalën e tij përshëndet të pranishmit, duke u uruar paqe, mirësi e dashuri. "Ju falënderoj nga Zemra ju që keni ardhur sot, nga viset e Kosovës, Shqipëria, Maqedonia e vende të tjera. Dua të falënderoj e t'i uroj jetë të gjatë Kryegjyshit Botëror Bektashian, Hirësisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, për ndihmën që na ka dhënë e na jep ne, që me ndihmën e Krijuesit, i cili për arsye angazhimesh nuk mund të ejtë sot këtu, të përmbushim detyrat tona në shërbesë të

besimtarëve, në udhën e ndritur të Haxhi bektash Veliut. Ju falënderoj dhe një herë të gjithëve. Zoti ju bekoftë!" - pohoi baba Mumini Lama.

Ndërkohë, të dërguarit e Selisë së Shenjtë Bektashiane në Tiranë, përshëndesin në emër të Kryegjyshit Botëror Bektashian dhe bëhen pjesë e riteve tradicionale të kësaj dite të shënuar. Ndër besimtarët, ka dhe nëpunës të administratës shtetërore, që këtë të dielë, kanë ardhur të kalojnë ditën e pelegrinazhit në këtë teqe. Masar Bakija, ish oficer në UÇK e në vazhdim dhe në strukturat e ushtrisë së re të Kosovës pohon: "...Ne gjakovarët jemi me fat që kemi këtë teqe të lashtë në qytetin tonë, që kemi përkujdesjen e bekimin e klerikëve bektashian në përmbushjen e detyrave tona në shërbim të kombit...!"

Festa bektashiane vazhdon më pas në drekën tradicionale të eventeve të tillë. Vonë, besimtarët marrin rrugën andej nga kanë ardhur, të mbushur me më shumë shpresë e besim, me më shumë dashuri për njeri-tjetrin...

Koresp. "Urtësia"





# SUKA... SI NJË ËNDËRR E BUKUR

**S'mund t'i harroj ato netët e bukura në teqe, ku së bashku me babanë dhe nënën time, pasi kishim shkarkuar hejbet me ushqime, uleshim në konakun e madh të mysafirëve. Babai im, Ali Këlcyra, sa herë shkonte në Francë, kujtohej të blinte ndonjë dhuratë për baba Kamberin dhe, sapo uleshim në ato shiltet e buta, thoshte: 'Hejvallah baba, këtë pata mundësi kësaj radhe!' Dhuratat ishin ose ndonjë këmishë e bardhë borë, ose ndonjë palë këpucë, ose ndonjë shami apo peshqir. Mbaj mend se baba Kamberi i merrte dhuratat, i vinte në buzë dhe në ballë nxitimthi dhe paskëtaj niste muhabetin me zë të shtruar.**

Një natë para pelegrinazhit në teqenë e Sukës, ftova Hëna Këlcyrën të shkonim së bashku në festë. Pashë se si dy sytë u shndërruan në dy oaze paqe dhe së bashku me falënderimin e thellë më shprehu dëshirën për të më rrëfyer diçka. "Jam shumë e lodhur, më tha, dhe nuk vij dot nesër. Po teqenë e Sukës dhe baba Kamber Meçon, i kam në sy, si tani. Dhe s'mund t'i harroj ato netët e bukura në teqe, ku së bashku me babanë dhe nënën time, pasi kishim shkarkuar hejbet me ushqime, uleshim në konakun e madh të mysafirëve.

Babai im, Ali Këlcyra, sa herë shkonte në Francë, kujtohej të blinte ndonjë dhuratë për baba Kamberin dhe, sapo uleshim në ato shiltet e buta, i thoshte: 'Hejvallah baba, këtë pata mundësi kësaj radhe!' Dhuratat ishin ose ndonjë këmishë e bardhë borë, ose ndonjë palë këpucë, ose ndonjë shami apo peshqir. Mbaj mend se baba Kamberi i merrte dhuratat, i vinte në buzë dhe në ballë nxitimthi dhe paskëtaj niste muhabetin me zë të shtruar.

Vonë, në mbrëmje, tri-katër dervishë shtronin sofrën dhe ky ishte çasti më

i gëzuar për mua. Gëzohesha se baba Kamberi më bënte një vend pranë vetes dhe çuditërisht, dollinë e parë e ngrinte për mua, pastaj vijonin të tjerat. Gjatë muhabetit, kishte një rregull, të pashkruar diku, por të ngulitur në mendjet e të gjithëve. Kur fliste dikush, të gjithë do ta dëgjonin në heshtje, sidomos kur fliste baba Kamber Meçu. Unë e kisha afër dhe e ndiqja me plot kureshtje, megjithëse vështirë të kuptoja fjalët e atyre burrave që flisnin për Kombin

dhe për Zotin. Rrallë herë, kur babai ishte në qejf, ja bënte me sy dervishëve dhe ata ja merrnin atyre këngëve të bukura bektashiane. Nuk mund të harroj kurrë ato net. Suka ka mbetur kurdoherë brenda vetes sime, si një ëndërr e bukur."

Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj është në Sukë, në ditën e pelegrinazhit. Ai është rrethuar nga besimtarët, të cilët duan ta takojnë dhe të flasin me 'të. Bisedat janë të shkurtra, të gëzuara me humorin dhe urtësinë e klerikëve dhe besimtarëve bektashianë. Dikush nga besimtarët e ardhur në teqe, ka ndjekur në televizor ceremonialin e mirënjohjes së Kongresit Hebraiko-Amerikan ndaj Kryegjyshit Botëror dhe do të dijë diçka më shumë. Kryegjyshi i përgjigjet duke i thënë se vlerësimi i tij, shkon për të gjithë klerikët bektashianë, të djeshëm dhe të sotëm, sepse mbi shpatullat e tyre ka rënë përgjegjësia e madhe historike jo thjeshtë për të vazhduar misionin e vyer bektashian, por edhe për ta mbajtur këtë tarikat të palëkundur, në mbrojtje të lirisë fetare dhe të paqes botërore.

Ylli Kasa, kujdestari i teqesë, i mbanë sytë nga muret e gurit. Të rrënuar, ata mure duhet se thërrasin lavdinë e shtuar, ato mote të kaluara kur oborri, mbushej plot me besimtarë dhe kur nga kazanët e mëdhenj, merrej ashurja për të ëmbëlsuar njerëzit. Në fëmijërinë e tij të parë, Ylli i ka përjetuar ato çaste të madhështisë bektashiane, siç ka ndjerë më pas dhimbjen e thellë kur rrënuar tyrbe e mezare, duke i

rënë fizarmonikës. "Kanë qenë kohë të çmendura", thotë Ylli si me gjysmë zëri. Ndërsa Kryegjyshi Botëror, me zërin e paqtë, u kujton të gjithëve aty, se ç'është bërë në këtë çerek shekulli lirie në krejt trevën e Përmetit. Ai flet për teqenë e famshme të Frashërit, të ringritur më së miri, si edhe për teqenë e Alipostivanit. Përmeti do të ketë sërish në kodrën mbi qytet, teqenë e re, një kryevepër fetare dhe arkitekturore. "Dal' nga dalë, vijon baba Mondi, se nuk i bëjmë të gjitha njëherësh. Jemi të vetmit, ne bektashinjtë që nuk trokasim në dyert e botës për ndihma. Është shumë e çmuar të mbështetemi vetëm tek shpirti i besimtarit tonë. E ka treguar historia se kush prej të huajve të ndihmon, avazin do e shohësh vonë. Ne, shyqyr Zotit të Lartë na kënaqin nefeset bektashiane, s'na dëgjojnë veshët melodi të tjera të huaja. Do bëhet edhe teqeja e Sukës. Nuk do t'i lëmë më këto rrënoja të na mërztin shpirtin. Por me durim, siç na porositi Haxhi Bektash Veliu. Edhe me shpresë. Të mos biem në krahët e shejtanit, por në krahët e mirësisë. Ta duam edhe teqenë, por edhe Shqipërinë".

Dielli i korrikut është ulur tanimë në Nemerçkë. Nga kodra ku ndodhet teqeja, pamja është e mrekullueshme. Disa pelegrinë, pasi kanë kryer ritet në tyrbe, pasi janë çmallur me Kryegjyshin Botëror Bektashian, ulen në barin e njomë të teqesë nën hijen e mureve të lashtë dhe përmes bisedash të gëzuara na ftojnë edhe ne pranë sofrës së muhabetit. Ne i falënderojmë dhe ata shumë të kujdesshëm, na përshëndesin: "Ju ndihmofshin ata baballarë me mezare!". Urim më të bukur dhe më të rrallë nuk gjen. Urim që mbanë brenda dëshirën e përjetshme për të qenë në vëmendjen e baballarëve, por edhe për t'i pasur ata kurdoherë të gjallë në jetën e përkohshme të kësaj bote. Mirupafshim në mote të tjerë vëllezër të besimit!

**Syrja Xhelaj  
Sukë, korrik 2019**



# BALLËM SULLTAN, vend që jep forcë



Brunilda Gorovelli

Çdo teqe dhe tyrbe bektashiane ka një datë ku të gjithë mbliidhen për të festuar. Vendi i mirë i Ballëm Sulltanit e ka në çdo vit në datën 29 qershor. Është e mrekullueshme ndërsa nisesh të udhëtosh në mëngjes herët me besimtarë të moshave të ndryshme, fëmijë, të rinj dhe të moshuar. Një aktivitet i përvitshëm i Kryegjyshit Botëror Bektashianë që të jep çdo herë përjetime të veçanta e asnjëherë të njëjta. Përveç besimtarëve të zonës së Martaneshit, dhjetra besimtarë u nisën nga Tirana për të qenë në shpellën e shenjtë, duke përshkuar rrugën mes për mes maleve. Gjatë gjithë rrugës të shoqërojnë pemët e larta të pyjeve, luleshtrydhet e egra që duken kaq të shijshme, dielli i nxehtë dhe era e lehtë që të ledhatonte si për të të mbrojtur nga rrezet e forta e për të na e bërë rrugën më të lehtë. Ende pa shkuar aty, duket që shenjtëria e tij të shoqëron përgjatë udhëtimit. Besimtarët më në moshë tregonin histori të veçanta për fshatrat ku ne kalonim, por me interesante ishte fshati i quajtur Biza. Një fshat ku lendina ishte plot me gjelbërim e pak me tutje gjendeshin ndërtesa të vjetra të kohës së komunizmit që nga besimtarët cilësoheshin si "pallate". Mes maleve dhe pyjeve, ku tek-tuk gjendej ndonjë shtëpi, ti mund të shikosh edhe pallate 2-3 katëshe. Të lëna ashtu të shkreta, por që mbajnë në vete histori të madhe. Pak më tutje të pret liqeni artificial, i madh, i

bukur, e i qetë... e ndërsa hedh vështrimin më tej qëndron stoike shpella e lashtë e Ballëm Sulltanit, Pirit të Dytë të bektashizmës.

Pas kësaj panorame që shfaqet para syve të tu, një bukuri mahnitëse mbërrin në teqenë e Ballenjës, e cila pret e përcjell njerëz në këtë ditë të shenjtë. Me veçanta e tyre ishte ndërtesa e parë e rindërtuar me mure guri, tashmë një teqe muze (kështu shpreheshin besimtarët që ishin atë ditë aty). Për këtë ndërtesë 3-kateshe ata treguan dhe një histori mjaft mbresëlënëse, e cila vinte në pah fuqinë e vendit të shenjtë dhe të Pirit të Dytë të Bektashizmës. "Gjatë kohës së luftës babai që ka shërbyer është gjendur përpara faktit të prishjes së teqesë, por fuqia e tij mistike bëri që forcat ushtarake të mpiheshin sa të mos lëviznin, ndaj u dorëzuan duke rregulluar edhe dëmet që kishin shkaktuar", tregon një nga besimtarët. Kështu duke treguar histori, mbërritëm në selinë ku na priste baba Hysni për t'a përshëndetur dhe uruar në këtë ditë të shenjtë, e të merrnin uratën nga vendi i shenjtë. Në zemër të gjithë vendit shikoje makina të shumta, çadra të ngritura gjith-andej, dhe sofra të shtruar në tokën e shenjtë. Qindra pelegrinë gëzueshëm hidhnin valle teksa prisnin që të mbërrinte edhe Kryegjyshi, Haxhi Dede Edmond Brahimaj. Pak më tutje ndodhej një çesem, e cila kishte ujë të ftohtë akull, ku besimtarët freskoheshin herë pas herë. Ngjitja e shkallëve të lashta, të çon drejt dhe tek shpella, e ndriçuar në këtë ditë nga drita e shumtë e qirinjve. Në brendësi të saj

mban mistikën dhe freskin që çdo besimtar ndjen teksa lutet dhe nder qirinj. Besimtarët luten të gjejnë shërim për hallet dhe problemet e tyre. Të shumtë ishin ata që kishin vendosur që të kalojnë natën aty, në shpellën mistike pranë mezareve, ku temperaturat qëndrojnë njësoj si dimër e verë. Vizitat bëhen në teqen e Ballenjës ku i pret dhe përcjellë baba Hysni, i cili ka vite që drejton këtë teqe të bukur rindërtuar gjithë nga e pare me punën dhe përkushtimin e tij. Sekretari Skënder Gjoni duke organizuar dhe afruar njerëzit në ceremonialin që do të organizohet me këtë rast, është i qeshur dhe me dashmirësi uron pelegrinët e ardhur nga Tiranë, Durrësi, Lushnja, Bulqiza, Elbasani, Librazhdi. Por vijin njëri pas tjetrit klerikët e gjyshitës së Elbasanit baba Faiku dhe dervish Admir Selmani, baba Sadik Ibrokdheli nga teqeja e Melçanit të Korçës, dervish Mikel Onjea nga teqeja e Turanit të Tepelenës me besimtarët e tij, baba Halil Curri nga teqeja e Bllacës së Dibrës

Sigurisht në këtë ditë të rëndishme të Ballëm Sulltanit ishte i pranishëm edhe baba Mondit, i cili i ka uruar mirëseardhjen besimtarëve, përfaqësuesve të institucioneve kulturore dhe lokale. Në fjalën e tij për pjesëmarrsit në këtë ditë të veçant midis të tjerave Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve tha: "Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë t'ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në ditën e sotme dhe i lutem Zotit të Lartë të jetë pranë jush në çdo ditë të kësaj bote dhe në tjetrën, Fati dhe mbarësia u ultë në sofrat tuaja, në sofrat tona të dashurisë së Ehi-Bejtit. Kemi gati tri dekada që më çdo 29 qershor mbliidhemi në Ballenjën tonë, në këtë vend të bekuar, në të cilin historitë e Haxhi Bektash Veliut, Ballëm Sulltanit, si dhe qindra dervishëve dhe baballarëve bektashianë, përcillen ende sot me respektin e thellë të brezave. Ky pelegrinazh është jo vetëm një stacion i takimeve të mrekullueshme me historinë, por edhe vazhdim i bisedave me njeri-tjetrin, me mezarët e teqesë, me hallet dhe gëzimet e pranishme në jetën fizike dhe atë shpirtërore. Sepse historitë ne bektashinj të si kemi perceptuar në 2 asnjë rast fletë të vjetruara në arkiva, por si mësim të vyer për sot dhe për nesër.

Ky vend i bekuar që na ka mbledhur sot, i rrethuar nga fryma dhe mirësitë e Ballëm Sulltanit, ka shfaqur në shekuj shumë mrekulli. Por pa më të voglin dyshim, mrekullia më e madhe e këtij vendi është frymëzimi që ai u ka dhënë brezave të martaneshasve, për t'u dalë në çdo kohë, Zot, fatit të kombit të tyre dhe familjeve të tyre. Ky frymëzim është transmetuar ndërkaq prej klerikëve tanë, të cilët në krejt kontributin e tyre fetar, i panë të lidhura ngushtë, në mënyrë më harmonike, ndjenjat hyjnore të besimit në Zot si dhe ndjenjat e kulluara për Shqipërinë tonë. Martaneshasit e reflektuan dhe reflektojnë ende sot, hadithin profetik që thotë se: "dashuria për atdheun kalon nga besimi", dhe kjo ka bërë që në çdo kohë, sado e vështirë të ketë qenë ajo, burrat e kësaj treve e kanë thënë fjalën e tyre të mençur, e kanë shfaqur trimërinë e

tyre të skajshme. Baballarët që kanë shërbyer tek ky vend i mirë, por edhe në teqetë e tjera të Martaneshit, që nga baba Hysen Mali dhe deri tek më i fundmi, babai i sotëm, Hysni Shehu, kanë mundur gjithashtu të shpërndajnë tek besimtarët edhe respektin e thellë për dije. Njihet kontributi i tyre për çeljen e shkollave në vitet e lëvizjes autonomiste shqiptare, sikundër shohim sot se djem edhe vajza të kësaj treve, mbushin sheshet e tyre me dashurinë e çiltër për librat, për atdheun, për familjen e madhe shpirtërore por edhe për atë fizike. Ne na gëzon një fakt i tillë dhe këto vlera të mëdha për kohën që kalojmë, ja atribuojmë përveç të tjerave edhe mençurisë së tarikatit bektashian, e cila ushqen lidhjet e besimit në Zot, duke shpërndarë dashuri për të gjithë. Shqipëria e sotme nuk është Shqipëria siç do ta donin të parët tanë, ata që dhanë gjënë më të shtrenjtë, jetën, vetëm e vetëm që ky truall arbëror të kishte paqe dhe mbrothësi.

Shqipëria e sotme nuk është ashtu siç e donin dhe siç e parafytyronin ata baballarë e dervishë bektashianë, të cilët u përballën edhe fizikisht me armiqtë tanë, vetëm e vetëm për liri dhe përparim. Realiteti i sotëm është jo vetëm i trishtë, por shumë larg nga rruga që nisëm së bashku, në vitet 90-të të shekullit që lamë pas. Por ne, asnjëherë nuk duhet ti humbasim shpresat, asnjëherë nuk do e dorëzojmë veten në errësirë. Ne do të mbetemi të bashkuar si më parë dhe do ti lutemi Zotit të Lartë të na japë forca për ta dashur atdheun, për mos ta braktisur atë. Sepse politika dhe politikanët tanë sot janë këta, nesër ikin dhe vijnë të tjerë. Shqipëria mbetet. Ky është atdheu, i cili na ndjek pas tërë jetën, deri në Australinë e Largët.

Ballem Sulltani ka qenë dhe do mbetet një shenjtor i madh dhe reformator i madh i Bektashinjve, i cili ka dhuruar paqe, dashuri dhe mirësi njerëzimit ndaj do mbetet i paharruar. Edhe një herë ju faleminderit të gjithëve që erdhët sot. Një falënderim i veçantë shkon gjithashtu për vëllanë tim dhe tuajin, baba Hysni Shehun, i cili po ja rrit krenarinë teqesë së Ballenjës dhe vendeve të mira të Martaneshit, duke sakrifikuar jetën e tij, duke ringritur besimin e Haxhi Bektash Veliut, në shpirtat e martaneshasve."

Pas fjalës përshëndetëse dhe lutjes së bërë nga Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, fjalën e morën edhe përfaqësues të tjerë të qendrave kulturore që ishin të pranishëm aty, ndërkohë nuk munguan edhe poemat mistike drejtuar vendit të shenjtë, interpretuara nga të rinjtë të cilët ishin veshur me kostume popullore. Vizita mbresëlënëse në shpellën e Ballëm Sulltanit ishte e mrekullueshme. Sejcili duke medituar dhe nderur qirinj nga pelegrinët u përlën me respekt dhe murën mirësinë dhe dashurinë e shenjtorit të madh të bektashizmit. Dita vazhdon më drekën dhe nefeset bektashiane, të cilat këndohen bashkarisht me baballarët, dervishët dhe besimtarët e shumtë.

# Nga Kolonja në Backë

## Në 200 vjetorin e lindjes së baba Fetahut

Nga Nuri Çuni

### Kush ishte Baba Fetahu?

Fetah Abdurrahman Xhelaj, lindi në vitin 1819, në katundin Kolonjë të Kurveleshit nga fisi Xhelaj. Ai ndërroi jetë rreth vitit 1906. Nëna Gastare, nga fisi Mele, lindi Fetahun dhe katër vajza. Abdurahmani, merrej me bujqësi dhe blegtori. Nuk vazhdoi gjatë, ai vdiq para kohe duke lënë të ve gruan dhe jetim djalin katër vjeçar dhe vajzat, që të gjithë në një moshë të vogël. Në këto kushte të vështira ekonomike, nëna u detyrua të martohej me Alem Gëraçin duke marrë me vete edhe fëmijët. Fetahu deri në moshën trembëdhjetë-katëmbëdhjetë vjeçare punonte në bujqësi dhe bari me bagëti në fshat. Qysh në këtë moshë viheshin re cilësitë e tij, i zgjuar, i shkathët me adhurim në besim. Mbaroi medresenë me rezultate të mira në Gjirokastër. Më vonë vazhdoi shkollën fetare në Turqi, ku përveç shkollimit u njoh edhe me simbolikën e kulteve fetare. Vizitoi vendet e shenjta: në Stamboll, Ankara, Qëndrën Botërore Bektashiane në Haxhi Bektash e shumë vende të tjera të shenjta, brenda dhe jashtë Turqisë. Fetahu pati një zell të madh për të njohur besimin bektashian, literaturën e saj dhe tek ai u shfaq dëshira e adhurimit për këtë besim. Kjo erdhi natyrshëm, hap pas hapi duke u njohur dhe duke vepruar, hyri në thellësi të njohjes së kulturës dhe misticizmit bektashian, u bë myhib dhe dervish.

U kthye në Shqipëri në vitin 1861, mbas disa vizitave të teqeve në jug të vendit u vendos në teqenë e Melçanit të Korçës me porosi të vëllezërve Frashëri dhe atdhetarëve të tjerë shqiptarë, që ishte lidhur gjatë kohës së qëndrimit në Stamboll. Këtu u vesh baba dhe së bashku me baba Hamidin punoi në zonën e Korçës dhe Gor-Opar për besimin bektashian, gjuhën shqipe dhe atdhetarizëm. Më vonë u vendos në teqenë e Backës që kish filluar të ndërtohej nga baba Hamidi i teqesë së Melçanit. Nga ana arkitektonike u bë një mrekulli e vërtet dhe ruan edhe sot e kësaj dite atë art të veçantë. Në portën e saj në krahun e majtë gdhendi shqiponjën dykrenare dhe simbolet e tjera fetare, unikal të teqeve në Shqipëri. Me ushtrimin e shërbimit fetar bektashian, lidhjet e ngushta me banorët e zonës me fjalën e urtë të Zotit, e besimin ndaj tij, me veprën atdhetare dhe arsimdashëse, shpejt tërhoqi vëmendjen dhe u bë i njohur në popullsinë e zonave të Potomit, Korçës, Kolonjës, Skraparit e Përmetit. Ndodhej në çdo hall e shqetësim, ndihmonte të varfërit, pajtonte njerzit në grindje dhe mëri, edukonte me fjalën



e ngrohtë, dashuri për atdheun. Arriti një autoritet të tillë te njerzit, sa që banorët vendas e kthyen në një mit, duke u betuar: "për baba Fetah" dhe "Allahu e baba Fetahu". Mbahti lidhje të ngushta me teqetë e dëguara të Melçanit, Qesarakës, të Frashërit dhe Prishtës. Ishte miku i ngusht i baba Alushit, ku takimet me patriotët e rilindjes kombëtare i bënte në dervishijen e Gostomickës. Veprimtar në kuadrin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit duke marrë pjesë aktive në degët e saj në Shqipërinë e Jugut. Ai mori pjesë në mbledhjen e organizua nga baba Alushi dhe Abdyl Frashëri në teqenë e Frashërit në fundin e majit të vitin 1878 së bashku me baba Meleq Staraveckën. Teqeja e Backës u bë qendra e çetave atdhetare të Lace Backës, Çerçiz Topullit, Mihal Gramenos, Sali Butkës, Qamil Panaritit, Shahin Matrakut. Në teqenë e Backës u organizua edhe një kuvend në vitin 1893, me një pjesëmarrje të gjerë, ku në mes

të tjerash u vendos edhe për hapjen e shkollave shqip. Për këtë vit, baba Fetahu hapi në teqe një kurs në gjuhën shqipe me 70 vetë dhe në vitin 1900, hapi në Backë shkollën e parë shqipe.

Sigurisht në periudhën e rilindjes kombëtare baba Fetahu njihet si nga të parët e përhapjes së gjuhës shqipe në zonën vakëfeve, që përfshin fshatrat: Katund, Stratobërdë, Trebickë, Panarit, Grabockë dhe Vithkuq, të cilat kanë një natyrë të mrekullueshme. Kjo zonë ndodhet në juperëndim të Korçës. Në kujtimet e Gani Katundit shkruhet: "se Katundi ishte një fshat i vogël, mbas Lidhjes së Prizrenit u bë i njohur si në gjithë zonën për përhapjen e ideve të rilindasve dhe përhapjen e gjuhës shqipe pothuajse në gjithë vakëfet. Një rol të veçantë e ka luajtur teqeja e Backës-Skrapar me baba Fetahun e famshëm. Ai njihet si baba i mençur, i drejt, i dashur me të gjithë.

Ai ishte i matur, i drejt me një parashikim të jashtëzakonshëm, udhëqëqës fetar që fitoi emër dhe simpati pa kufi. Në popull fjala e tij s'behej dy. Në këtë periudhë të ligësive, hajdutërisë e të kaçakut, kur drejtësia nuk pinte ujë, nga puna e baba Fetahut në këtë qark të Korçës vjedhjet dhe dhunimet ishin të rralla. Ky i ndalonte ose i pakësonte me punën e tij. Në këtë kohë para vitit 1900 një djalë konaku Dhosi i Tasit, nga Katundi, i zgjuar dhe punëtor mësoi shkrim dhe këndim këndonte këngë patriotike si "Që më një të kollozhekut... ", i cili e kishte mësuar nga baba Fetahu. Dhosi kur shkoi në emigrim Amerikë u bë prift dhe shërbeu në kishën e Bostonit. Në fshat vinin libra shqip dhe abetare që ishin botuar në shtypshkronjën "Mbrothësia" të Sofjes, ato i dërgonte dhe i shpërdante baba Fetahu në vakëfet. Kështu shkrimin dhe këndimin e gjuhës shqipe, njëri pas tjetrit e mësuar djemt dhe vajzat e Katundit.

Ushtrimin e besimit bektashianë e lidhi ngushtësisht me çështjen atdhetare shqiptare. Motoja e tij ishte: "Pa atdhe nuk ka fe". U lidh me Petro Nini Luarasin, i cili e furnizonte me libra shqipe. Ai dergoi në teqenë e Qesarakës dy dervish për t'i përgatitur si mësues nën drejtimin e Petro Nini Luarasi. Ajo u bë qendra e çetave atdhetare të Lace Backës. Baba Fetahu ka qënë bashkohës i baba Ali Haqi Elbasanit të teqesë së Zallit (dajua i baba Selim Ruhit) që ndërroi jetë në vitin 1906. Por baba Fetahu nuk ishte vetëm një njeri fetar, atdhetar e arsimdashës, ai ishte një nikoqir i mirë ku për interesa të teqesë dhe të popullit në rrethe, hapi dyqan pranë teqesë, dyqan në dervishije dhe Korçë, ndërtoi dy mulli bloje, dërstilë te përroi i Staraveckës, në Vlushë dhe dy mullinjë në dervishije dhe sharrë me ujë për prerje druri në Sherë të Panaritit të Korçës për ndërtime, një sipërfaqe të madhe të mjaftueshme në malin e Faqekuqit për të kullotur njëmijë kokë dele të teqesë. Ai ngriti teqenë në dervishije në fund të Miçanit, së bashku me dervish Rexhepin nga Qafa e Skraparit duke e kthyer në një burim të ardhurash në perime, vreshtë dhe drurë frutorë etj. Sa gazetat e kohës shkruajnë për këtë dervishije me famë në jug të Shqipërisë dhe shiteshin prodhimet në Korçë. Për të këndohen këngë të shumta nga populli.

Vlersimet për baba Fetahun janë bërë nga Komisioni i vetqeverimitit në vitin 1937: "Baba Fetahu i teqesë së Backës ka qënë një



nacionalist i dëguar në qarkun e Skraparit dhe ka punuar me zell patriotik për realizimin e idealit Kombëtar. Pak ditë pas lidhjes së Prizrenit ka venë në portën e teqesë së Backës gurin e gdhendur me shqiponjën dy krenore duke u thënë popullsisë së atij rrethi se ky zog një ditë do të jetë flamuri i Shqipërisë. Kjo shenjë ndodhet edhe sot në portën e kësaj teqeje. Komisioni vendosi pagëzimin e shkollës Radshit me emrin e tij". Është dekoruar dy herë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, me rastin e 50 vjetorit të Pavarësisë me "Medaljen për veprimtar patriotike" në vitin 1962, me "Urdhërin për veprimtar patriotike të klasit të dytë" në vitin 1982, gjithashtu në vitin 1995 dekuruar nga Presidenti i Republikës Sali Berisha me Medaljen për veprimtar patriotike. Dhe nga Presidenti Ilir Meta iu dha titulli "Naim Frashëri" në maj 2018. Midis fshatit Gostëncë dhe Gramsh të Skraparit ndodhet "Lisi i baba Fetahut" shpallur monument natyre.

### 10 maj në Kolonjë

Një vit më parë Kryegjyshi u tha kolonjarëve, se viti 2019 është viti i baba Fetahut, i cili ka 200 vjetorin e lindjes. Këtu u hap sipari për këtë ngjarje të rëndësishme. Kjo u prit nga të gjithë me duartklotje dhe gëzim të veçantë. Por me masat organizative të marra gjatë katërmujorit të parë, të këtij viti, në takimet me pleqsinë e fshatit dhe shoqatën atdhetare kulturore "Kolonja", grupi i muzeut të bektashizmit të Kryegjyshit Botërore Bektashiane, u arrit të meren masa konkrete në përgatitjen e festës së 10 majit të përvitshëm në Kolonjë dhe Backë të Skraparit si lajmërimet, përgatitja e dekorit dhe programit artistik etj.. Me ndihmën e shoqatës "Kolonja" me kryetar z. Resul Mele, sekretari Ehem Graci e shokët e tjerë, Pajtim Graci, z. Asim Mele, kryeplaku i fshatit z. Fadil Frëngu dhanë ndihmesën e tyre për festimin e 200 vjetorit të lindjes. Kërkimi në Arkivin e Shtetit, në Gjirokastër, Berat dhe nga të moshuar sollën të dhëna të rëndësishme për këtë figurë të klerikut bektashian gjatë rilindjes kombëtare. Në këtë mënyrë u bë piketimi i fotoekspozitës, vendlindja e baba Fetahut dhe vepra e jeta e tij në teqenë e Backës dhe përgatitja e muzeut të ardhshëm.

I moshuari Zenel Kosha stërnip i baba Fetahut ka vite që in-



Mes gëzimit dhe duartrokitjeve pjesmarrësit uruan Kryegjyshin dhe kryeplakun e fshatit. Me këtë rast u shtrua edhe një drekë mikëpritje nga fshati Kolonjë. Në biseda dhe këngët vazhduan deri në mbrëmje në këtë ditë të mrekullueshme në kujtim të baba Fetahut mbetet nderi dhe krenaria e bektashizmit.

## 20 qershor në Backë

Gjatë periudhës maj qershor në teqenë e Backës ishte një kantier i vërtet ndërtimi, në dorën e fundit të mermetimit dhe restaurimit të teqesë. Puna u përqëndrua në ambientet e shumta që ka teqaja e Backës me një arkitekturë të veçantë është një kompleks arkitektonik i rrallë në Ballkan.

Sekretari Zalo Qato me shqetësimin për ta patur gati më 20 qershor pothuajse çdo ditë ishte i pranishëm të shikonte realizimin e detyrave duke organizuar punën, sjellja e bazës materiale. Ai bëri gjithçka që duhej. Dyert dhe dritare me dru të stazhionuar duke përshtatur me ato originale, tavanet me ngjyrën dhe formën që ka patur. Të bie në sy mobilimi i dhomës së pritjes, kafe oxhaku me postiqe dhe minder, divane dhe me të gjitha portretet e baballarëve është një mobilim me shije dhe pranë saj dhoma ku rrinte baba Fetahu me të gjitha shtresat dhe mbulesat i japin bukuri të veçantë. Kujdes është treguar për të ruajtur gjatë punimeve simbolet bektashiane dhe mbishkrimet që jan disa. Gjithashtu duken qartë simbole me gdhendje mbi gur si: luani, teslime, kali me kalorsin me shpat, zogj, dele etj., reliefet e gdhendura me kompozicione figuriale zoomorfe japin prezencën religjioze, që paraqesin Hysenin, Aliun apo luanin si personifikim. Në teologjinë bektashiane këto simbole të veçanta atributojnë Aliun, Hysenin, familjen Ehli-Bejt, Haxhi Bektash Veliun, betejën e Qerbelasë etj., tregojnë simbole të besimit bektashian, të cilat kërkojnë studim të thelluar për të nxjerr në pah vlerat e mëdha që ka kjo teqe.

Por në këtë periudhë u bë një punë e veçantë nga grupi i muzeut të bektashizmit nga z. Enver Kushi, Sotirulla Hoxha, Nuri

teresohet për të nxjerr të dhëna për këtë klerik të njohur. Një ditë në Kryegjyshatën Botërore, kur ish Kryegjyshi Dede Reshat Bardhi, 10 vjet më parë, z. Zenel Kosha i dorëzoi disa shënime, këngë e poezi, kujtime nga fshati Kolonjë. Ai fliste me pasion, e dashuri se çfarë të bëjmë që të gjejmë edhe foton e vjetër të baba Fetahut. Dedei mbasi e falenderoi për interesimin e tij, e përqafoi dhe e uroi për shëndet dhe mbarësi. E porositi mos u ndaj punës që ke filluar por grumbullo sa më shumë material dhe dokumenta, kujtime e gjithçka që flitet për baba Fetahun, se nesër del një libër për të. Por Zeneli nuk e harroi porosin e dedeit, ai punon edhe sot në këtë moshë madhore e nxit që të bëhet një libër për këtë klerik të famshëm. Z. Asim Mele po kërkon dhe është afuar për të gjetur foton e baba Fetahut, po e presim.

10 maji i bukur i luleve dhe natyrës së mrekullueshme në fshatin Kolonjë, aroma e tyre, të deh dhe me një kënaqësi të veçantë i afrohes fshatit dhe kujton se në këtë vend të Kurveleshit të Sipërm lindi kleriku i famshëm baba Fetahu. Të rinj dhe të reja, gra e burra dhe të moshuar bëjnë ritualin bektashian, meditojnë dhe në një qetësi të veçantë ndezin qirin dhe luten për mbarësi dhe shëndet, e hallet e sejcilit për të gjetur qetësinë shpirtërore dhe shpresën për tu bërë më e mira e familjes, fisit dhe fshatit.

Kulmin festa e arriti në mbasditën e kësaj dite, tek sheshi me rrapin shekullor dhe burimin e ftohtë në mjedisin e bukur të qendrës së fshatit. Në këtë jubile të veçantë mori pjesë Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Hirësia e tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, Kryetari i Bashkisë Tepelenë, z. Tërmet Peçi, klerku dervish Mikel Onjea dhe gjithë të ardhurit nga zona e Kurveleshit, Tepelenës, Gjirokastrës, nga Tirana dhe këshilli i Gjyshatës bektashiane të Skraparit. Në këtë atmosferë gëzimi dhe krenarie u çel ceremoniali me hymnin kombëtar dhe moderatori, z. Pajtim Graci drejtoi me mjeshtëri artistike gjithë aktivitetin. Kryeplaku i fshatit, Fadil Frëngu uroi mirëseardhjen. Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Haxhi Dede Edmond Brahimaj u tha: "Ne e mbajtmë fjalën do të vinim përsëri në këtë jubile 200 vjetorin e lindjes. E kemi në traditë që figura të tilla si baba Fetahu, ti kujtojmë dhe vlerësojmë kontributin e gjithë klerikëve bektashian gjatë rilindjes kombëtare, siç qe klerku juaj nga Kolonja, që la emër dhe lavdi në teqenë e Backës, Skrapar, Korçë, Kolonjë dhe Përmet. Ne do ti vazhdojmë festimet në këtë event edhe më 20 qershor në teqenë e Backës-Skrapar."

Sipas programit u hodhën themelet për ngritjen e teqesë së baba Fetahut, në qendër të fshatit nga Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, u vendosën gurët e parë nga Kryegjyshi dhe dervish Mikeli, Urimi për të gjithë. Gëzuar teqen!



Çuni duke hedhur hapin e parë për një dhomë muzeale me rreth 22 stenda në konceptimin muzeal të historisë së bektashizmit, vështrimi historik e arkeologjik i fshatit Backë dhe vendlindja e baba Fetahut, vepra dhe kontributi i tij në teqenë e Backës. Ditë më parë u bë e mundur vendosja e stendave dhe gjithë dhomat e mëdha dhe koridori i harqeve u vendosën stenda të mëdha të Kryegjyshve Botërore e të tjera. Banderola e madhe dekori rreth teqesë krijoi një ambient festiv dhe qysh në mbrëmjen e datës 19 maj filluan të vinin pelegrinët e parë nga Korça, Përmeti, Skrapari dhe mëngjezi e gjeti teqen me shumë pelegrinë, rini dhe fëmijë, emigrant nga Anglia, Italia dhe Greqija dhe të moshuar. Pelegrinët filluan të bënin ritualin te mezari i baba Fetahut, ndezja e qirinjeve u shtuan gjatë mesditës duke u mbushur sheshi para teqesë. Këngëtari i njohur Dule Malindi me shokët e tij i dhanë një gjallëri të veçantë kësaj feste me këngët dhe nefeset bektashiane, u therën shumë kurbanë. Kjo ditë e shënuar mori pamjen e një pelegrinazhi të vërtet në rrezë të malit Lirzë.

Fjalët dhe urimet për këtë ditë ishin nga të gjithë pjesëmarrësit. Në ceremonialin e organizuar me hymnin kombëtar u uroj mirëseardhjen sekretari Zalo Qato pjesëmarrësve mbas asaj që u bë në Kolonjë e Gjirokastrës më 10 maj. Ai u uroj mirësi dhe dashuri gjithë pelegrinëve dhe ta mbajmë gjallë traditën e baba Fetashut. Më pas dervish Sali Peti lexoi mesazhin e Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve, Haxhi Dede Edmond Brahimaj: "Jemi krenar që sot 20 qershor 2019, kujtojmë 200 vjetorin e lindjes së baba Fetahut dhe ky është viti i baba Fetahut, e cila mbart brenda vetes një simbolikë të veçantë. Jeta dhe vepra e këtij kleriku mendjendritur këtu në teqenë e Backës bëri histori. Ai ngriti teqenë me një akitekturë të veçantë, u bë një mrekulli. Në portën e saj gdhendi shqiponjën dykrenare dhe simbolet e tjera fetare, unikal të teqeve në Shqipëri. Gjatë periudhës së lëvizjes autonomiste shqiptare, teqetë bektashiane u shndërruan në vatra të përhapjes dhe mësimi të gjuhës shqipe. Kjo lëvizje atdhetare kombëtare në bashkëpunim me institucionet bektashiane, e kishte të qartë se fatet e atdheut vendoseshin me pushkë dhe penë, prandaj dervishët e baballarët punuan me devizën se "Pa atdhe nuk ka fe". Këtë e bëjnë edhe patriotët e fshatit Backë, Staraveckë, Helmës, Melckë, Nikollarë dhe Potom, gjithë zona, si i thonë edhe



Skrapari i Sipërm. Baba Fetahu me veprën atdhetare dhe arsimdashëse, u bë i njohur në popullsinë e këtyre zonave dhe të Korçës, Kolonjës, Skraparit dhe Përmetit. Atë e gjeje kudo edukonte me fjalën e ngrohtë, dashuri për Zotin, dashuri për atdheun. Arriti një autoritet të tillë te njerzit, sa që banorët vendas e kthyen në një mit, duke u betuar: "për baba Fetah" dhe "Allahu baba Fetahu". Hapi shkollë për këtë trevë, nga ku morën dijet e para ata luftëtarë lirje që mbushën radhët e luftëtarëve në të gjitha përpjekjet shqiptare të viteve 1878-1912. Sigurisht historianët do të shkruajnë dhe do të plotësojnë më së miri veprën madhështore të këtij kleriku të madh që la emër dhe gjurmë në jetën e tij. Ne përulemi sot me respektin më të thellë ndaj baba Fetahut. Klerikët e teqesë së Backës, dervishijes dhe teqetë e tjera në Skrapar, Përmet dhe Korçë dhe Kolonjë, të cilët jo vetëm që mbajtën gjallë frymën e atdhetarizmit, por edhe bënë çështje e mundur të edukonin breza të tërë me ndenjat e solidaritetit, vëllazërisë dhe të shqiptarizmit.

Unë gjej sot rastin të falenderoj gjithë popullin e Backës e zonës së Potomit, të cilët me shpirtin e mrekullueshëm njerëzor, bënë që mesazhet dhe traditën bektashiane që mbolli baba Fetahu e vazhduan dhe e mbajnë edhe sot. Ne kërkojmë që rinia të mos largohet jashtë vendit. Ne i lutemi Zotit që të mbyllet kjo histori por t'i rikthehemi jetës dhe besimit në këto troje, në këto vende të bekuara që na lanë të parët. Me këtë rast më lejoni të falenderoj gjyshatën bektashiane të Skraparit me sekretar Zalo Qato, që ka bërë një punë të mrekullueshme në rimëkëmbjen e teqesë së baba Fetahut duke i dhënë lavdinë e saj, si një monument i rrallë i historisë shqiptare. Ndaj me ju mendimin se përvjetorë të tillë, si ky 200 vjetor i lindjes së baba Fetahut duhet të na vlejnjë të gjithëve jo vetëm sepse kujtojmë të kaluarën tonë, por edhe për të punuar më shumë për të ardhmen". Kurse përfaqësuesi i shoqatës Atdhetare "Kolonja" z. Pajtim Graci solli falenderimet dhe zërin e kolonjarëve të Gjirokastrës për këtë mirënjohje të thellë dhe dashuri pakufi për baba Fetahun, për të bashkëpunuar edhe më shumë në të ardhmen e ndriçuar sa më shumë këtë figurë të njohur. Myhibi më i ri, Ali Bardhi për herë të parë që merr pjesë në këtë pelegrinazh recitoi një poezi për baba Fetahun. Bashkëbisedimi me pelegrinët me respekt dhe dashuri për këtë ditë të shënuar baba Faik Selmani, dervish Mikel Onjea, floën për klerikun e shquar baba Fetahun në këto male për lirinë e Shqipërisë. Recitime dhe këngët vazhduan në gjithë ditën e kësaj feste. Organizimi i një dreke nga gjyshata e Skraparit dha mesazhin e bisedave të ngrohta dhe këngët për baba Fetahun, sollën dashuri për të gjithë, të cilëtmuarën me vehte jo vetëm gëzimin por edhe përkushtimin për të bërë më shumë në të ardhmen duke mbajtur gjallë besimin e kulluar bektashian.

# URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE  
BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË  
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANË  
NR.133 KORRIK 2019

